

INSTITUTI I  
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR  
POLITICAL STUDIES

LSAPHOTO.COM



INSTITUTI I  
STUDIMEVE  
POLITIKE

**REFORMA NË DREJTËSI**

**BILANCI 2018-2019**

**MONITORIM, ANALIZË, PROBLEMATIKA**

INSTITUTI I  
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR  
POLITICAL STUDIES

**REFORMA NË DREJTËSI**  
**NGA VETTINGU TEK JETËSIMI I INSTITUCIONEVE TË REJA**  
**BILANCI I REFORMËS 2018-2019**  
**MONITORIM DHE PROBLEMATIKA**

**GUSHT 2019**



Instituti i Studimeve Politike (ISP) vijon të kryejë monitorimin e ecurisë së reformës në drejtësi. Fokusi i monitorimit janë ecuria e ligjeve të reformës, niveli i zbatimit të ligjit dhe Kushtetutës, bilanci i strukturave të rivlerësimit, ngritja e institucioneve të reja, ligjërimi politik e publik si dhe perceptimi publik mbi reformën në drejtësi, sfidat dhe problematikat

Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e stafit të ISP.

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

DREJTUES I EKIPIT TË RAPORTIT

Afrim KRASNIQI

ISBN 978-9928-4418-9-8

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2019

*INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE*

*Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*Email: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al) dhe [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com)*

*Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies*

*Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë*



## TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRMBAJTJA E LËNDËS
2. GJETJET KRYESORE DHE PRITSHMËRITË
3. HYRJE
- 3.1. MAZHORANCA PRO REFORMËS? PESË ARGUMENTE KRITIKE
- 3.2. PD PRO REFORMËS? PESË ARGUMENTE KRITIKE
- 3.3. LSI DHE REFORMA: BASHKËJETESË E PAMUNDUR?
- 3.4. FAZA E TRANZICIONIT: KUSH KONTROLLON SISTEMIN?
- 3.5. KED, ROL PARËSOR POR ME FUNKSIONE PART – TIME]
- 3.6. KAKOFONI DHE PREMTIME PA SENS PËR ZGJEDHJEN E ORGANEVE TË REJA
- 3.7. GJYKATA KUSHTETUESE...NË PRITJE TË KATËR EMRAVE
- 3.8. GJYKATA E LARTË, PA PRURJE TË REJA DHE ME TË DELEGUAR NGA APELI
- 3.9. KED, ROL PARËSOR PËR GJYKATËN KUSHTETUESE DHE INSPEKTORIN
- 3.10. KANDIDATËT NË SISTEMIN E RI: PESË PROBLEME THELBËSORE
- 3.11. KONFLIKTI I INTERESIT? MUNGESË STANDARDESH DHE PRAKTIKASH
- 3.12. SPAK, “SHPËTIMI” I REFORMËS NË DREJTËSI?
- 3.13. KOMISIONI I MONITORIMIT NË KUVEND, “NJË ZGJIDHJE E DËSHTUAR”
- 3.14. “POLI I DREJTËSISË DHE DISA TË FAKTE TË TJERA RRETH TIJ
- 3.15. KEQKUPTIMET “NDËRKOMBËTARE” DHE VETTINGU
- 3.16. RËNIA E NDIKIMIT TË SHOQATAVE TË GJYQTARËVE
- 3.17. VETTING, KARRIERË DHE ... POLITIKË?
4. VETTINGU 2019: BILANCI, PROBLEME DHE GJETJET KRYESORE
- 4.1. DSIK DHE STANDARDET KRITIKE TË VLERËSIMIT
- 4.2. PROBLEMATIKA ME REFERIMET E VENDIMEVE TË VETË KPK
- 4.3. RASTI “SEVDARI”, PASOJAT NË KLP, ONM Oponencë KPA-SË
5. KPK, BILANCI DHE PROBLEMATIKA TË FUNKSIONIMIT
- 5.1. KPK, DERI NË 20 MUJ KUHË PËR VENDIM NDAJ SUBJEKTEVE TË VETINGUT
- 5.2. KPK, 36% SUBJEKTE TË SHKARKUARA VS 42% TË KONFIRMUARA
- 5.3. SHPËRNDARJA E ÇËSHTJEVE NË KPK: NGA 62 NË 34 RASTE PËR PERSON
- 5.4. KPK, NDARJE E PËRGJEGJËSISË SË RELATORËVE NË GJYKIME
- 5.5. KOMISIONERËT MË “LIBERALË” GJATË VETINGUT NË KPK
- 5.6. KOMISIONERËT MË TË ASHPËR NË VETTING (KPK)
- 5.7. KOMISIONERËT NË “PAKICË”: BILANCI NË VENDIMET PËR SHKARKIM NË KPK
- 5.8. KOMISIONERËT NË PAKICË: BILANCI NË VENDIMET KONFIRMUESE NË KPK
6. KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT: BILANCI, RISI DHE PROBLEMATIKA
- 6.1. KOLEGJI I APELIT: VETËM 1 NGA 33 SUBJEKTE GJYKIMI SHËNOI SUKSES
- 6.2. EFIKASITETI I GJYQTARËVE TË KPA, BILANCI SI RELATORË
- 6.3. KPA: KOHA PËR VENDIM, NGA 4 NË 8 MUJ
- 6.4. KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT E RRËZOI KPK NË 21% TË RASTEVE
- 6.5. VENDIME UNANIME NË KPA? VETËM NË 68% TË RASTEVE
- 6.6. INA RAMA DHE REZARTA SCHUETZ, 4 HERË NË PAKICË NË KPA
7. IKP DHE ONM: BILANCI I RIVLERËSIMIT
- 7.1. IKP, VETËM 13% ANKIMIME NDAJ KPK NË KOLEGJIN E APELIT
- 7.2. ONM DHE BILANCI I ANGAZHIMIT NË MONITORIMIN E VETTING
- 7.3. ZBARDHJA E VENDIMEVE, NEVOJA PËR UNIFIKIM TERMASH/EMRASH



## 2. GJETJET KRYESORE DHE PRITSHMËRITË

---

Reforma në drejtësi po kalon vitin e parë të jetësimit të institucioneve të reja të drejtësisë, KLGJ, KLP dhe KED. Viti 2019 shënoi kalimin nga retorika për reformën tek jetësimi i reformës. Faza e tranzicionit midis sistemit të vjetër dhe të ri të drejtësisë ndeshi në një vështirësi të pafalshme për autorët e reformës, - dy vjet pas nisjes së procesit të vettingut vendi është ende pa Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë funksionale, me Prokuror të Përgjithshëm të përkohshëm, me mungesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorisë së Posaçme anti-korrupsion.

- Pritshmëritë që gjashtë muajt e parë të vitit 2019 të legjitimoheshin institucionet e reja nuk u përmbushën. Procedurat e zgjatura të procesit të rivlerësimit, mungesa e kandidaturave cilësore konkurruese, vonesat në vendosjen në funksion të plotë të KLGJ, KLP dhe KED, si dhe fokusimi i axhendës politike tek kriza politike para e pas-zgjedhore, - ishin disa nga faktorët që ndikuan në shtyrjen e fazave konkurruese dhe përzgjedhëse për institucionet e reja. Premtimet për afate optimiste rezultuan jo të sakta dhe mbeten tregues të paaftësisë për njohjen e sistemit apo të spekulimit me reformën.

**Reforma në drejtësi deri në dhjetor 2018 funksionoi vetëm si proces vettingu, pra rivlerësimi të subjekteve në sistemin e drejtësisë.**

- Pas dhjetorit reforma është zhvendosur në funksionimin dhe vendimmarrjet e KLGJ, KLP dhe KED. Pavarësisht se këto institucione janë kontestuar nga një pjesë e politikës nuk ka prova bindëse se vendimmarrja e tyre e deritanishme ka pasur natyrë politike dhe diskriminuese për shkak të bindjes. Cilësitë dhe preferencat personale të drejtuesve të këtyre institucioneve nuk janë reflektuar në vendimmarrjen fundore të tyre. Praktikrat e reja të ndjekura prej këtyre institucioneve, me gjithë problemet që shfaqin, në thelb janë pozitive dhe demonstruese të vullnetit për ndryshim. Problematike mbetet situata në KLP për shkak të vendit të përsëritur vakant dhe vendimmarrjeve të marra nga anëtarë tashmë të larguar nga vettingu.

**Reforma nuk është më prioriteti kryesor në axhendën politike, pavarësisht se është zhvillimi më i rëndësishëm për Shqipërinë. Ajo vijon të zhvillohet në një kontekst të vështirë politikë dhe përmes kontestimeve të konsiderueshme nga brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë.**

- Partitë kryesore politike janë *de facto* kundër jetësimit cilësor të reformës, duke e konsideruan drejtësinë e ri si rrezik potencial për gjithçka ato kanë administruar dhe administrojnë në shtet e në shoqëri. Secila parti politike e shikon reformën si mjet kërcënues për palën tjetër dhe vettingun si proces që po pastron mbështetësit e palës tjetër politike në sistem. Asnjë parti politike nuk ka dhënë deklaram zyrtar publik në mbështetje të një vendimmarrjeve të KPK apo KPA, si dhe nuk ka përfshirë në rregullat e tyre të brendshme heqjen e mbështetjes politike për individët e larguar nga sistemi i drejtësisë dhe që mund të kenë ambicie politike.



- Konflikti midis Presidentit dhe Qeverisë, kritikata e Presidentit ndaj rolit të faktorit ndërkombëtar në reformën në drejtësi, nisma e mazhorancës për shkarkimin e kryetarit të shtetit në momentin kur ai duhet të emërojë anëtarët në Gjykatën Kushtetuese, si dhe retorika denigruese ndaj reformës nga opozita apo keqpërdorimi i sukseseve të reformës si suksese politike nga mazhoranca, janë e mbeten tregues të faktit se elita politike është e mbetet opozita më e fortë ndaj një sistemi drejtësie të ri, të ndershëm, të pavarur, me integritet dhe profesional.
- Funkcionimi i vettingut nuk ka rritur funksionimin e nivelit të drejtësisë në Shqipëri, në kuptimin më të gjerë qytetar, - në rritjen e reagimit të drejtësisë ndaj skandaleve korruptive, ndaj dosjeve abuzive dhe ndaj rasteve flagrante të shkeljes së ligjit prej individëve të pushtetshëm në qeveri, në parlament, në bashki, në polici, në institucione dhe në krye të partive politike. Pra, reforma ende nuk ka arritur tek pritshmëria e madhe që përmes saj të jepet realisht drejtësia dhe që drejtësia të jetë e njëjtë për të gjithë qytetarët, pavarësisht rangu shoqëror, bindjeje politike apo niveli jetese.
- Anketimet, përfshirë me stafet akademike të fakulteteve të drejtësisë, në grupet e gjyqtarëve apo në grupet me ekspertë juristë kanë treguar se ka diferencë të dukshme midis mbështetjes së madhe që reforma gëzon tek qytetarët e shoqëria dhe mbështetjes së rezervuar të saj nga stafet akademike dhe ekspertët ligjorë. Natyra eksperimentale e reformës në drejtësi në Shqipëri mbetet pika më e fortë, por edhe më e dobët e saj. Risia që e bën atë unike rrit shumë më tepër pritshmëritë sesa vetë kapacitete e reformës për t'i përmbushur ato. Nga ana tjetër, debati mbi standardet e vendimmarrjeve në procesin e rivlerësimit apo mbi prurjet në institucionet e reja të sistemit, mbeten lëndë e parë në debatet publike pavarësisht se ato shpesh janë dominuar nga debati mbi persona konkretë dhe jo mbi bazën e re ligjore, sistemin e ri dhe garancitë institucionale të funksionalitetit të tij.

**Deri në fundin e muajit gusht 2019 kanë kaluar procesin e rivlerësimit rreth 189 subjekte, nga të cilat 69 janë vendime shkarkimi dhe 38 janë vendime dorëheqjesh. Statistikisht ky është një rezultat i lartë dhe tregues i thellësisë dhe ashpërsisë së procesit të rivlerësimit. Statistikat kanë vlerë, por në dhënien dhe garantimin e drejtësisë ato mbeten relative.**

- Analiza profesionale e tij tregon se rivlerësimi ka shfaqur probleme në standardet e ndjekura, është përqendruar kryesisht tek kontrolli i pasurisë dhe produkti nuk është gjithnjë vlerësimi i aftësisë sa është vërtetimi se individit "i ka letrat në rregull". Ikja nga sistemi e disa figurave të njohura të botës akademike apo me përvojë pozitive vendimmarrëse sidomos në Gjykatën Kushtetuese, mund të arsyetohet vetëm nëse prurjet zëvendësuese të tyre të jenë në të njëjtin nivel apo më profesionalë, - një pritshmëri shumë më tepër optimiste sesa realiste në rrethanat aktuale.
- Jetësimi i institucioneve të reja u përball edhe me vështirë të paparashikueshme. Vendi i masivizimit të diplomave juridike, po vuan të gjejë juristë kandidatë për vendet vakante. Kriteret e forta, skepticizmi ndaj konkurrimit, ndrojtja ndaj lakimit të emrit në publik apo **edhe frika e denigrimit** nga palë të ndryshme në gjykim (politikë, media, komunitet, etj), ishin disa prej faktorëve pengues për prurje të reja masive, ndërkohë që shumica e ofertave u bazuan tek emra "të vjetër" të sistemit të vjetër, të cilët kërkojnë riciklimin edhe në sistemin e ri. Për rrjedhojë, duke pranuar se jemi një vend i vogël me resurse të kufizuara njerëzore dhe mungesë të traditës dhe të potencialit konkurrues



pjesa më e madhe e proceseve të kandidimit kanë ecur përpara përmes nxitjes dhe apeleve publike e jopublike nga faktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, kryesisht SHBA dhe BE.

- Vettingu në drejtësi ka pasur dhe ka një ndikim të madh kulturor. Ai krijoi perceptimin publik se të paprekshmit, të fuqishmit, të pasurit për shkak të posteve zyrtare, rrethi vicioz vendimmarrës, etj, në demokraci përballen me llogaridhënien dhe paguajnë kostot e gabimeve apo sjelljeve të tyre. Kultura e nevojës për të legalizuar çdo akt, çdo veprim financiar, çdo të dhënë profesionale dhe çdo tregues të karrierës është një kulturë e re, dhe njëherësh një investim serioz drejt një demokracie më funksionale e shteti të së drejtës.
- Vettingu është bërë model frymëzimi edhe për vettingun në politikë, në polici, në botën akademike, në institucione të tjera kryesore dhe në grupet e tjera me ndikim në shoqëri. Fakti se të gjithë duan vetting dhe marrin drejtësinë si model për të, është edhe tregues i nevojës së shoqërisë për katarsis, por edhe i besimit se reforma në drejtësi, edhe në variantin më negativ, është e mbetet zhvillimi më i rëndësishëm dhe më pozitiv në Shqipëri.
- Gjatë 2019 u mbyll paketa e ligjeve të reformës në drejtësi dhe u reflektuan në ligje vendimet e Gjykatës Kushtetuese (2017). Qeveria zgjidhi më në fund problemin e godinave për institucionet e reja dhe buxhetin mbështetës, Shkolla e Magjistraturës po funksionon dhe një numër donatorësh ndërkombëtarë janë përfshirë në ecjen përpara të reformës.
- Analiza e të dhënave të KPK, KPA, IKP, KED, etj, meriton hulumtimin jo vetëm të bilancit zyrtar, të punës së çdo individi vendimmarrës brenda tyre, por mbi të gjitha, të vlerësimit të standardeve dhe problematikave dhe të rekomandimit të rrugëzgjdhjeve sa më optimale. Materiali i mëposhtëm merr në analizë vendimmarrjet në KPA, në KPK, rolin e IKP dhe të OMN, tregon risitë dhe mangësitë, standardet e respektuara dhe ato të injoruara, problemet dhe sfidat.

**Pritshmëritë për vitin 2019 lidhen jo vetëm me zhvillimet në vetë sektorin e drejtësisë, por edhe me zhvillimet politike dhe raportin e Shqipërisë ndaj procesit integruar.**

- Pritshmëritë optimiste të pjesës së mbetur të vitit 2019 janë të tilla sa të parashikojnë zgjedhjen e katër anëtarëve të rinj në Gjykatën Kushtetuese (dy Presidenti dhe dy Parlamenti) për të arritur kuorumin vendimmarrës me 5 anëtarë. Gjithashtu mund të bëhen hapa seriozë që në vjeshtë të kemi edhe Prokurorin e Përgjithshëm dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për këtë të fundit, nëse KED arrin të klasifikojë pesë kandidatë sipas kërkesave të ligjit. Po ashtu mund të shpresohet që në fundin e vitit të kenë kaluar fazën e parë të vettingut të gjithë kandidatët për SPAK dhe që në fillim të vitit të ardhshëm të shpresohet që kjo strukturë të jetë funksionale.
- Pritshmëritë e reformës nuk lidhen vetëm me reformën, por edhe me progresin e vendit. Nëse kriza politike gjen zgjidhje të shpejtë, pavarësisht ose jo alternativës për zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, reforma në drejtësi do ta ketë më të lehtë të funksionojë dhe do të jetë më i shpejtë procesi i jetësimit të institucioneve të reja që nuk janë burim i votës në parlament. Nëse kriza thellohet dhe jeta politike bllokohet, pasojat do të ndjehen dukshëm edhe në ecurinë e reformës në drejtësi.



Reforma do të ndikohet edhe nga vendimmarrja e Bashkimit Evropian mbi Shqipërinë. Një votë mbështetëse për Shqipërinë do të ishte një mbështetje e qartë e shumicës qytetare që kërkon ndryshim dhe demokraci funksionale, më shumë kontroll mbi politik-bërjen dhe vendimmarrjet politike dhe më shumë standarde, llogaridhënie e transparencë për reformat. Nëse vendimi mbetet negativ, vala zhgënjyese dhe lodhëse do të ketë pasoja edhe në rënien e besimit tek reformat e rëndësishme, siç është reforma në drejtësi dhe ajo zgjedhore.

Së fundi, reforma në drejtësi ka nevojë jetike për mbështetje publike, jo në formën e nismave kolektive të modelit të një sistemi që kemi lënë pas 30 vjet më parë, por në kuptimin e mbështetjes cilësore dhe ta matshme për risitë dhe ndikimet pozitive të saj. Reforma ka nevojë gjithashtu për qasje më realiste nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, - për kritika e ndërhyrje konstruktive sa herë vendimmarrjet apo akte të veçuara përbëjnë devijim nga standardet kushtetuese të reformës, por edhe për nevojën jetike për transparencë, llogaridhënie, integritet dhe vizion strategjik.





### 3. HYRJE

Gjatë vitit 2019 reforma në drejtësi vijoi të ishte prioritet i debatit politik dhe publik, sidomos në axhendën e përfaqësive kryesore ndërkombëtare, SHBA dhe BE. Nëse gjatë vitit 2018 reforma u përqendrua kryesisht në procesin e vettingut, gjatë vitit 2019 vëmendja kryesore u përqendrua në procesin e jetësimit të institucioneve të reja në drejtësi. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi funksionuan me ngarkesë të plotë dhe nën presionin për të marrë vendime sa më të shpejta për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, për zgjedhjen e Gjykatës Kushtetuese si dhe për zgjedhjen e SPAK dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Zhvillimet konfliktuale politike të vitit 2019, sidomos protestat dhe vendimi i opozitës për dorëzimin e mandateve dhe pas bojkotit të saj, vendimi i mazhorancës për të zhvilluar zgjedhje lokale pa parti të tjera konkurruese, - pjesën më të madhe të vitit zhvendosën vëmendjen nga ecuria e reformës në drejtësi. Një numër skandalesh korruptive të zyrtarëve të lartë, përfshirë katër ish ministra dhe më shumë se 12 deputetë, disa kryetarë bashkie dhe zyrtarë të tjerë të lartë, - të gjithë të pa gjykuar dhe të pa dënuar nga drejtësia në tranzicion, - ndikuan në krijimin e një hendeku midis pritshmërisë së madhe publike të reformës në drejtësi dhe rezultateve reale të sistemit aktual të drejtësisë. Sondazhe të ndryshme, kryesisht ato që nuk patën sfond politik dhe as orientim të donatorëve për të nxjerrë rezultate më të larta mbështetëse sesa kuotat reale të mbështetjes, detyruan shpeshherë faktorët ndërkombëtarë, sidomos partnerët strategjikë të investohen me deklarime, fushatë sensibilizuese dhe me aktivitete në favor të përshpejtimit të reformës në drejtësi dhe të nevojës që “të pa ndëshkueshmit, përfshirë politikanët” të japin llogari për aktet e tyre korruptive.

*Me gjithë defektet, problemet, pakënaqësitë, pritshmëritë, komentet dhe mitizimin, reforma në drejtësi është e mbetet zhvillimi më i rëndësishëm politik e kushtetues në Shqipërinë e pesë viteve të fundit. Suksesi i saj, edhe në një formë më minimale sesa pritshmëritë, mund të jetë suksesi më i madh afatgjatë për Shqipërinë, sidomos në kushtet kur reformat e tjera, përfshirë reformën politike, kanë mbetur në vend ose kanë bërë hapa negativ pas.*

ISP, 2019

Midis fjalëve “integrim”, “taksa”, dekomunizim”, “bashkëpunim rajonal”, “dialog politik”, fjala më e përdorur, më e cituar dhe më headline gjatë 2019 në ligjërimin politik e publik ishte “SPAK”.

- Të gjitha palët politike akuzojnë njëra tjetrën se kanë frikë nga SPAK dhe secila palë politike premton se pas krijimit të SPAK do të jenë aty për të denoncuar krimet apo korrupsionin e palës tjetër.
- Shoqëria civile dhe media, grupe qytetare dhe partnerë, e cituan SPAK si një dritë në fund të tunelit ku është futur tranzicioni, si një mekanizëm që do t'i detyrojë politikanët dhe zyrtarët e lartë të japin llogari.
- Skenat ku disa individë të korruptuar dhe arrogantë, deri dje pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes në sistemin e drejtësisë, - dolën në proces vettingu, dhanë llogari për pasuritë, të kaluarën dhe vendimet e tyre, - janë e mbeten unike në historinë tonë të tranzicionit, një revolucion social me pasoja pozitive të pamatshme.



- Prej periudhës kur ka nisur vettingu është rritur niveli i “ligjshmërisë” në llogaritë bankare të zyrtarëve, sidomos të njerëzve në sistemin e drejtësisë apo atyre që po hyjnë aty, duke e ditur se një ditë edhe ata do jenë aty për të dhënë llogari.

Nga ana tjetër, ka pasur e ka zyrtarë politikë, sidomos ata që kanë pushtet në mazhorancë, të cilët reformën në drejtësi e kanë parë si instrument presioni e shantazhi ndaj rivalëve politikë në opozitë, pa qenë të ndërgjegjshëm se një reformë reale në të ardhmen do t’i vendosë edhe ata vetë përpara llogaridhënies.

Disa debate publike, sidomos midis Presidentit, Qeverisë, eksponentëve të opozitës dhe drejtuesve të institucioneve të reja të drejtësisë, krijuan vazhdimisht përshtypjen se në rastin më të keq e gjithë elita politike është kundër reformës dhe në rastin më të mirë të gjithë kanë frikë prej saj.

Ecuria e reformës dhe pritshmëria ndaj veprimit të munguar të drejtësisë u ndesh me një realitet kritik dhe unikal, - mbetjen e vendit prej kohësh pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, me Prokuror të Përgjithshëm të përkohshëm dhe pa strukturë kontrolluese të disiplinës në sistemin e drejtësisë. Pavarësisht arsyeve dhe motiveve, afatit kohor apo argumenteve të tjera që përdoren, kjo situatë është e mbetet e papranueshme, dëmtuese për shtetin dhe demokracinë, minuese për besimin tek drejtësia dhe mohuese të shumë prej të drejtave kushtetuese të shtetasve.

Debati rreth e mbi drejtësinë e re, vuri edhe njëherë përballë dy qëndrime, - atë optimist dhe shpesh utopik të diplomatëve dhe faktorit ndërkombëtar si edhe atë skeptik dhe shpesh realist të opinionit të ekspertëve vendas. Dy palët duket se jetojnë në dy vende të ndryshme dhe ndaj edhe shohin dy vende të ndryshme. Mbështetja ndaj reformës është dhe duhet të jetë e vazhdueshme, por mitizimi i saj, refuzimi i çdo kritike dhe përpjekja për ta paraqitur atë si unike ne planet, nuk i bën mirë as reformës dhe as besimit publik afatgjatë të qytetarëve tek drejtësia, tek demokracia dhe tek partnerët tanë ndërkombëtarë.

Reforma në drejtësi aktualisht përballlet me tri probleme thelbësore:

1. Nevoja emergjente për të hapur procesin e krijimit të një trupe vendimmarrëse brenda Gjykatës Kushtetuese, për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për krijimin e SPAK dhe të trupës vendimmarrëse në Gjykatën e Lartë.

*Disa njerëz mund të kenë frikë nga reforma gjyqësore dhe të jenë të gatshëm ta pengojnë atë, por kjo nuk mund të lejohet. Është përgjegjësi e të gjitha institucioneve shqiptare, partive politike, si dhe e shoqërisë civile, që të sigurojnë se forcimi i pavarësisë, paanësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit përmes këtij procesi është i garantuar. Muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë, teksa Shqipëria do të kalojë nga faza e tranzicionit të reformës gjyqësore në zbatimin e saj të plotë.*

*Genoveva Ruiz Calavera  
Maj 2019*

*Reforma në drejtësi është ndoshta ‘perla e Shqipërisë’, e rajonit apo në botë... Me rëndësi që së shpejti të ketë një Gjykatë funksionale, por edhe të balancohet shpejtësia dhe cilësia e punës.... Bashkimi Evropian ka vendosur 42 milion euro për të konsoliduar këtë arritje historike dhe për të finalizuar reformën. Për të mirën e çdo qytetari shqiptar.*

*(Luigi Soreca, EU Ambasador)*



2. Nevoja për të kaluar nga vettingu (një prej fazave të reformës në drejtësi) në jetësimin e drejtësisë në të gjitha nivelet (thelbi i reformës në drejtësi)
3. Nevoja për ta avancuar procesin e reformës me hetime të mëtejshme dhe masa ligjore për të gjitha subjektet e shkarkuara që kanë rezultuar se kanë kryer akte korruptive në vendimmarrjen e tyre në drejtësi, si dhe për të kaluar nga vettingu në drejtësi tek vettingu në politikë, ku realisht ndodhen figura shumë më të rëndësishme dhe më me ndikim afatgjatë në drejtësi sesa vetë kryetarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

“ Reforma në drejtësi e theu atë kapje të paligjshme të sistemit të drejtësisë dhe po ia kthen atë njerëzve... Shtetet e Bashkuara kanë qëndruar krah Shqipërisë dhe i kanë nxitur këto ndryshime të mëdha. Ne qëndruam krah Shqipërisë kur reformat u miratuan njëzëri tre vjet më parë. Ne kemi qëndruar krah Shqipërisë kur filloi rivlerësimi dhe ndërsa ai ka pastruar sistemin e drejtësisë. Ne kemi qëndruar krah Shqipërisë gjatë krijimit të Këshillave të Gjyqësorit dhe të Prokurorisë. Ne jemi duke qëndruar krah Shqipërisë ndërsa po ngrihet SPAK-u. Jini të sigurtë, ne do të vazhdojmë të qëndrojmë krah Shqipërisë ndërsa Reforma në Drejtësi i jep një formë të re të ardhmes tuaj. ”

*E Ngarkuara me Punë  
Leyla Moses-Ones*



Siç shihet sfidat nuk janë pjesë e mandatit të organizmave që merren me reformën në drejtësi dhe realisht përbëjnë një hendek të madh midis asaj që presin qytetarët dhe asaj që i ofrohet aktualisht në kuadër të paketës së reformës.

- Emërimet më të ndershme në drejtësi do të jenë të pafuqishme nëse nuk shoqërohen me reformim të Policisë së Shtetit, të ILDKPI dhe strukturave të hetimit financiar, të DSIK dhe të organeve të tjera të sigurisë, si dhe me reformim të vetë sistemit përfaqësues në vend.
- Problemet me dekriminalizimit edhe në zgjedhjet e tashme vendore (periudha post-zgjedhore) janë tregues se sistemi i drejtësisë nuk vepron i vetëm dhe nuk është e nuk mund të jetë efektiv sa duhet nëse nuk mbështetet qoftë edhe me vullnet politik nga faktorët e tjerë.
- Gjithashtu, sado që ndërkombëtarët janë mbështetës dhe po e çojnë përpara reformën, përgjegjësia afatgjatë për t'i dhënë jetë e qëndrueshmëri reformës është e mbetet shqiptare. Diplomatët dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë mandate kohore të përcaktuara, ndryshojnë periodikisht, ndërsa shteti, shoqëria e qytetarët janë e mbeten këtu, të pandryshueshëm dhe me nevoja jetike për një drejtësi e shtet të së drejtës funksional, të besueshëm dhe profesional.



### 3.1. MAZHORANCA PRO REFORMËS? PESË ARGUMENTE KRITIKE

Drejtesit kryesorë të mazhorancës vazhdimisht shprehen se janë pro reformës në drejtësi dhe e konsiderojnë atë suksesin më të madh edhe të mandatit të vet qeverisës.

Në ligjërimin e tyre politik reforma përdoret vazhdimisht, sidomos kur mazhoranca ndodhet përpara ndonjë akuze nga opozita politike. Në përgjigje, gjithnjë mazhoranca thotë se opozita ka frikë nga reforma në drejtësi, se kjo e fundit do tu japë përgjigjen e merituar, se reforma në drejtësi është zgjidhja e problemeve dhe se reforma po ecën vetëm falë mbështetjes së saj.

1. Në fakt, një analizë e ftohtë e raporteve të mazhorancës me reformën në drejtësi, të ofron argumente për të krijuar bindjen se ajo ka një perceptim të gabuar për reformën dhe mungesë reale vullneti politik për suksesin e saj. Për shembull, kryeministri thotë se e mbështet fuqishëm reformën pavarësisht se siç ai thotë, - nuk e ka lexuar paketën e ligjeve të reformës dhe as ndryshimet kushtetuese. Ai thotë se e mbështet reformën duke besuar tek ndërkombëtarët. Nga ana tjetër, ai nuk lë rast pa sulmuar e denigruar gjyqtarë apo prokurorë që marrin vendime që mund të cenojnë interesat e partisë së tij. Rasti më i fundit ishte vendimi i dy gjyqtarëve në Tiranë e Durrës lidhur me mandatet e të zgjedhurve vendorë. Gjyqtarët u denigruan publikisht dhe u paralajmërua largimi i tyre me reformën në drejtësi, - një e vendim që në asnjë rrethana nuk i përket as kryeministrit, as qeverisë, as parlamentit dhe as Partisë Socialiste në pushtet.
2. Po ashtu, një numër skandalesh ku janë përfshirë politikanë e zyrtarë të lartë të mazhorancës bënë headline në media dhe sjellja e mazhorancës përfshirë e kryeministrit në këtë rast ishte tipike: ata sulmuan ashpër prokurorët që kanë nxjerrë të dhënat në media, madje cituan emra konkretë, të cilës sipas tyre duhet të largohen e do të largohen nga sistemi i drejtësisë. Hetimet e Prokurorisë nuk i vërtetuan akuzat e tyre, por kjo ka pak rëndësi në politikë. Gjithashtu mazhoranca refuzoi të ndihmojë hetimet për skandale të tilla dhe mbështeti çdo masë administrative që pamundëson hetimin, përfshirë transferimet e vazhdueshme të dosjeve, deri në veprimin ekstrem, nisjen e procesit gjyqësor ndaj medias që publikoi skandalin.
3. Edhe në aspektin ekzekutiv, mazhoranca vonoi rreth një vit për të zgjidhur çështjen e ambienteve të punës së strukturave të reja në drejtësi, vonoi muaj të tërë të kalojë në parlament ligje të paketës së reformës që nuk kërkonin konsensus me opozitën, si dhe nga mënyra sesi u soll sidomos gjatë incidenteve me protestat e opozitës apo të fushatës elektorale, mbivendosi policinë e shtetit mbi organet e hetimit duke krijuar idenë dhe perceptimin se nuk është drejtësia por policia dhe qeveria që arreston, burgos dhe dënon.
4. Aspekti tjetër ku mazhoranca ka sjellje të gabuar ndaj reformës është investimi që ajo vijon të bëjë përmes zyrtarëve të lartë të saj, për të ndikuar në përzgjedhjen preferenciale në organet e reja të drejtësisë. Investimi është publik (duke anatemuar rivalët e mundshëm në garë) ose indirekt (përmes lobimit personal apo promovimit të anëtarëve të familjeve të individëve që duhet të marrin vendime për postet e reja në sistemin e drejtësisë).
5. Së fundi, mazhoranca është sforcuar në retorikën e saj se të larguarit nga sistemi janë përgjegjësi e opozitës së djathtë dhe e kohës kur ata kanë qenë në pushtet. Në fakt, një analizë krahasuese e të dhënave tregon se të shkarkuarit kanë qenë njësoj të mbështetur nga dy palët dhe se figura të njohura



të promovuara nga të majtët, përfshirë kryeprokurorë apo anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese, janë pjesë e të shkarkuarve. Mazhoranca nuk lë rast pa etiketuar gjyqtarë e prokurorë “me mbështetje të djathtë” që shkarkohen dhe nuk ka një rast të vetëm të ketë mbështetur publikisht një vendim të KPK apo KPA për shkarkimin e gjyqtarëve apo prokurorëve “me mbështetje të majtë” gjatë viteve të tranzicionit.

### 3.2. PD PRO REFORMËS? PESË ARGUMENTE KRITIKE

Sjellja e opozitës politike ndaj reformës në drejtësi është vijim i sjelljes së saj ndaj një sërë vendimesh të rëndësishme të marra vitet e fundit në Shqipëri. Ajo gaboi kur bojkotoi reformën administrative apo zgjedhore dhe gjithashtu gaboi kur e konsideroi reformën në drejtësi si akt të njëanshëm të qeverisë dhe të mazhorancës. Mbështetja e saj për ndryshimet kushtetuese 2016 ishte më shumë produkt i presionit ndërkombëtar sesa tregues i vetëdijes për rëndësinë dhe vlerën e reformës.

1. Opozita thekson vazhdimisht se institucionet e reja të drejtësisë po kapen nga qeveria dhe mbështetësit e saj. Ajo e konsideron vettingun jo profesional dhe krijon idenë absurde se një skenar ndërkombëtar i mbështetur nga një kritik i Presidentit aktual amerikan, është duke u aplikuar në Shqipëri. Kjo ka bërë që opozita të mos arrijë të dallojë zhvillimet e rëndësishme të reformës nga defektet e saj, dhe të ketë të njëjtën qasje kritike “*en bloc*” ndaj reformës. Për shembull, opozita nuk ka përshëndetur zyrtarisht dhe publikisht asnjë rast të vetëm të shkarkimit të ndonjë gjyqtari apo prokurori nga vettingu, as në rastet më flagrante të provave për korrupsion apo paaftësi.
2. Opozita nuk ka sjellë fakte publike se mazhoranca është duke kontrolluar reformën apo është duke e dirigjuar atë. Për më tepër, duke e konsideruar tezën e saj si të qenësishme ajo ka bërë më pak denoncime në prokurori e gjykatë gjatë viteve 2018 - 2019 sesa gjatë viteve të parë të kalimit në opozitë 2013-2014. Frika politike se sukcesi i reformës do të mund të konsiderohet sukses politik i mazhorancës ka ndikuar në këtë qëndrim, pa arritur të bëjë dallimin midis krediteve dhe kostove që merr mazhoranca për shkak të skandaleve të shumta, të cilat sado që shtyhen përsëri mbeten lëndë e parë për hetime të mëtejshme pas krijimit të SPAK.
3. Opozita ndjehet e frustruar dhe e përjashtuar nga procesi i vendimmarrjeve të rëndësishme për reformën në drejtësi, por në fakt, individët e mbështetur prej saj gjatë kohës së konsensusit politik 2017 apo gjatë aplikimeve të ndryshme për postet e reja në institucionet e reja të drejtësisë nuk kanë ndonjë cilësi profesionale të admirueshme madje shpesh as të konkureshme. Në politikë sulmi ndaj një modeli të gabuar duhet shoqëruar me ofrimin e një modeli të ri më të mirë, tezë që opozita as nuk e ka realizuar dhe as nuk është investuar.
4. Një numër personash që realizojnë ligjërimin publik të opozitës për reformën në drejtësi janë vetë në konflikt interesi, pasi kanë qenë pjesë e strukturave përgjegjëse, palë në procese gjyqësore, objekt hetimi ose kandidatë për postet e reja në sistemin e drejtësisë. Edhe në nivelet më të larta politike, figura me rëndësi që atakojnë reformën në drejtësi janë gjithashtu në konflikt interesi politik pasi gjatë viteve kanë qenë mbështetës të fortë të disa prej subjekteve të shkarkuara me prova korrupsioni apo tregues të dukshëm negativ në integritet / anën profesionale.



5. Së fundi, mungesa e opozitës në parlament dhe aksioni i saj politik ka lënë shteg të hapur për kritikët e saj, shqiptarë apo ndërkombëtarë, të krijojnë idenë se opozita është radikalizuar për shkak të reformës në drejtësi, me qëllim pengimin e saj apo pamundësimin e suksesit të saj. Në fakt, gjatë bojkotit 2018 dhe 2019 nuk ka pasur ndonjë vendim me rëndësi në parlament ku kërkohej konsensusi i opozitës dhe qenia e opozitës në parlament lidhet me stabilitetin e funksionalitetin e shtetit, jo me ecurinë e reformës në drejtësi. E kundërta, mos pjesëmarrja aktive në parlament ka ndihmuar mazhorancën të veprojë lirshëm dhe pa dhënie llogarie në çdo vendim që lidhet direkt apo indirekt me reformën në drejtësi.

### 3.3. LSI DHE REFORMA: BASHKËJETESË E PAMUNDUR?

Partia më e avancuar kritike ndaj reformës në drejtësi, ecurisë dhe bilancit të saj mbetet LSI. Reforma mori jetë kur kjo parti kishte postet e tre ministrave të Drejtësisë, të cilët jo rastësisht u lanë jashtë procesit vendimmarrës për reformën. LSI vijon të jetë aktive në deklarata kundër bilancit të reformës në drejtësi dhe ta shohë atë si një proces të kontrolluar 100% prej kryeministrit.

- Retorika e saj, i bashkohet retorikës së Presidentit të Republikës dhe madje njësohen së bashku, duke mos parë pothuajse asnjë element pozitiv tek reforma dhe procesi i vettingut.
- Të dy palët, Presidenti e LSI kanë pasur të drejtë në paralajmërimet mbi krizën e mundshme në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, etj, por ligjërimi i tyre publik dhe sidomos adresimi i kritikave dhe përgjegjësi tek aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në reformën në drejtësi, kanë krijuar perceptimin e se ka një bashkëjetesë të pamundur midis tyre dhe vetë reformës në drejtësi, asaj që nisi, asaj që është dhe asaj që mund të jetë në të ardhmen.
- Presidenti dhe LSI mbeten aktorë të rëndësishëm vendimmarrës, sidomos në vendimet lidhur me vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese (Presidenti) dhe në vullnetin politik për reformën (LSI), ndaj edhe është e pritshme që argumentet e tyre të dëgjohen, por edhe që qëndrimet e tyre të jenë më koherente dhe realiste ndaj reformës në drejtësi dhe konceptit të së drejtës së munguar në Shqipëri.

### 3.4. FAZA E TRANZICIONIT: KUSH KONTROLLON SISTEMIN?

Një prej pasojave të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me reformën në drejtësi është edhe e drejta e subjekteve të rivlerësimit për të dhënë dorëheqje nga procesi i vettingut në çdo kohë që ata e quajnë të arsyeshme, por gjithnjë para sesa procesi i vettingut të nisë.

- Për rrjedhojë ka raportime të shumta sipas të cilave individë me shanse minimale për të kaluar me sukses vettingun, janë duke përfituar nga periudha e tranzicionit derisa të vijë radha e tyre e vettingut, për të kryer akte korruptive në sistem apo për ta përdorur pozitën në drejtësi si burim përfitimi.
- Gjithashtu, KPK në vendimet e tij ka dhënë të paktën 10 vendime, në të cilat rekomandon hetime të mëtejshme e konkrete për subjektin në rivlerësim, - proces që nuk ka ecur përpara dhe deri më tani nuk ka asnjë strukturë që po merret me to.



Ushtrimi i kontrollit të tyre deri përpara pak kohësh bëhej nga KLD dhe inspektorati i tij. Tani që këto struktura nuk ekzistojnë dhe derisa të krijohet institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sistemi është pothuajse pa kontroll. Ushtrimi i kontrollit nga Ministria e Drejtësisë, nuk ka peshën, besueshmërinë dhe nivelin profesional të tillë sa të mbajë sistemin nën mbikëqyrje cilësore dhe të ndalojë / parandalojë fenomenet negative. Kjo është një prej arsyeve që vazhdimisht bëjnë headline në media lajme të bujshme të vendimeve skandaloze në gjykata apo në prokurori.

### 3.5. KED, ROL PARËSOR POR ME FUNKSIONE PART – TIME

---

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) u bë headline në media gjatë periudhës mars-gusht 2019, për shkak të rolit të tij të rëndësishëm në procesin e seleksionimit të kandidatave për në Gjykatën Kushtetuese dhe për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vetë institucioni vazhdimisht është ankuar për mungesë stafi dhe mjetesh mbështetës, - të cilat duhet të ofrohen nga Gjykata e Lartë. Për shkak të volumit të madh të punës, por edhe për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar në vetë Gjykatën e Lartë një sërë detyrimesh të KED që lidhen me organizimin dhe transparencë nuk janë përmbushur plotësisht ose tërësisht. Të tilla janë edhe problematikat në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të KED, por edhe një sistem më efikas e i besueshëm i transparencës publike në lidhje me vendimmarrjet e tij.

Aktualisht KED mbetet pikë referimi për zgjedhjen e organeve të reja, sidomos anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, - funksion që merr vlerë nëse KED arrin të ndjekë standarde shumë më të larta sesa ato që ka ndjekur deri më tani. Procedura përcakton të drejtën e individëve për të kandiduar për vendet vakante, gjithsesi, kriteret dhe procesi i seleksionimit dhe sidomos i seancave dëgjimore mund e duhej të ishte shumë më profesional dhe transparent, në mënyrë që minimalisht të mos dërgohen në Gjykatën Kushtetuese individë që janë më pak profesionalë sesa ata që ikën prej saj për shkak të vettingut.

Nga ana tjetër, detajet administrative dhe teknike nuk mund të kthehen kosto për thelbin e procesit, jetësimin e drejtësisë së re, ndaj edhe problemet e konstatuara në fazën e deritanishme mund e duhet të shmangen, në mënyrë që numri i kandidatëve të jetë realisht shumë më i lartë, cilësia e tyre të jetë shumë më konkurruese dhe produkti final të jetë shumë më i besueshëm dhe sa më konsensual në mbështetjen publike.

### 3.6. KAKOFONI DHE PREMTIME PA SENS PËR ZGJEDHJEN E ORGANEVE TË REJA

---

Një prej tipareve të ligjërit politik mbi reformën në drejtësi gjatë 2019 ishin deklaratimet jo koherente dhe premtimet pa sens lidhur me periudhën kur do të krijoheshin organet e reja të reformës në drejtësi, sidomos zgjedhja e SPAK, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Pothuajse të gjithë individët që kanë bërë deklaratime lidhur me afatet kur do të krijohen, - përfshirë kryeministri, Ministri i Drejtësisë apo edhe drejtuesit e KED, KLP e KLGJ, kanë gabuar në deklaratimet e tyre.



- **Qeveria shqiptare:** *“Brenda muajit maj – qershor 2019 do të jenë zgjedhur Gjykata Kushtetuese, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i LD dhe SPAK”* (dokument zyrtar paraqitur në Berlin, Bruksel dhe Paris, shkurt 2019)
- **Ardian Dvorani, Kryetar i KED:** *“Brenda muajit maj do të dërgojmë para Kuvendit dhe Presidentit listën e kandidatëve mes të cilëve këto institucione janë të detyruara të zgjedhin gjyqtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë”* (Tryeza e KSHH, 24.04.2019).
- **Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Ligjeve:** *“Brenda tre mujorit të parë të vitit 2019 ne do kemi Gjykatë Kushtetuese. Në mars besoj gjithçka do jetë e zgjidhur”* (Channel One, 6.11.2018) apo *“brenda qershorit 2019 ne do të kemi të plotësuar vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, por edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë”* (Fjalim në Kuvend, 8/5).
- **Gent Ibrahim, kryetar i KLP.** *“Dalja e dimrit dhe hyrja e pranverës do ta gjejë Shqipërinë me Prokurorin e ri të Përgjithshëm dhe me SPAK”, “fillimi i pranverës do ta gjejë Shqipërinë me këto institucione të rëndësishme të plotësuar”* (TCH, 21.12.2018), apo *“afati ka filluar dje (19 dhjetor), dhe brenda dy muajve duhet ngritur SPAK”* (Report TV, dhjetor 2018).
- **Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë** në takim me Ministrin e Drejtësisë së Holandës *“Procesi i filluar tashmë për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, ngritjen e Inspektorit të Lartë të drejtësisë do të përfundojnë deri në qershor të këtij viti”* (23.03.2019)

Siç shihet, më optimistët e parashikonin zgjedhjen e institucioneve të reja në mars-prill dhe më pesimistët në qeveri e parashikonin procesin në qershor –korrik 2019. Në fakt, jemi në prag të shtatorit 2019 dhe asnjë prej institucioneve të mësipërme ende nuk është zgjedhur dhe në rastin më të mirë zgjedhja e tyre do të bëhet përpara dhjetorit 2019.

Premtimet publike dhe afatet optimiste ndikuan në mbajtjen “gjallë” të entuziazmit për produktet e reformës, por në të njëjtën kohë treguan nivelin kritik të profesionalizmit dhe koherencës nga zyrtarët më të lartë (përfshirë të drejtësisë së re), si dhe qasjen jo realiste që politika, qeveria dhe institucionet kanë ndaj përgjegjësive të tyre për reformën në drejtësi dhe produktet e saj finale.

Deklarime të tilla meritojnë edhe seancë dëgjimore / hulumtim tjetër me vetë protagonistët, - p.sh, nga Komisioni i Monitorimit të Reformës në Kuvend, për t’i pyetur se çfarë nuk ka funksionuar që nuk janë respektuar afatet ose përse kanë dhënë afate publike.

### 3.7. GJYKATA KUSHTETUESE...NË PRITJE TË KATËR EMRAVE

Gjatë 2019 Gjykata Kushtetuese vijoi të mos ishte funksionale. Anëtarja e vetme e mbetur në këtë Gjykatë, Vitore Tusha, u rrëzua nga mazhoranca në konkurrimin e saj për postin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ndërkohë që mandati i saj në Gjykatë ka përfunduar. Ajo vijon të mbetet në detyrë në pritje të zëvendësimit, por kjo është kriza më e rëndë e Gjykatës Kushtetuese që prej dorëheqjes së disa anëtarëve më 1994 apo shkarkimit të kryetarit më 1998. Me procedurat e tanishme të KED në rastin më të mirë mund





të kemi katër anëtarë të rinj brenda vjeshtës, për të arritur numrin 5 nga 9 anëtarë, të mjaftueshëm për ta bërë atë vendimmarrëse, megjithëse jo të plotë.

Në garën për Gjykatën Kushtetuese procesi mbetet i hapur sidomos për sa i përket mënyrës sesi do të operojnë Presidenti dhe Parlamenti në zgjedhjet e tyre. Sipas Kushtetues secili institucion duhet të zgjedhë një nga tre emrat e listës, sipas renditjes së kandidatëve nga KED për vendin vakant. Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejtë apo kandidatët nuk marrin numrin e votave të nevojshme në Kuvend, atëherë renditja e listës së KED mbetet përcaktuese.

Për shkak se janë pothuajse të njëjtit emra që konkurrojnë për disa pozicione të lira në Gjykatën Kushtetuese dhe për shkak se në çdo pozicion kërkohen së paku tre kandidatë, atëherë në kombinime të ndryshme mund të ndodh që Presidenti e Parlamenti të zgjedhin nga dy kandidatë, por mund të ndodhë edhe që secila palë të ketë mundësi të zgjedhë nga vetëm një kandidat. Duke qenë një çështje sa teknike, aq edhe e vullnetit politik është në dorë të këtyre institucioneve mënyra e koordinimit dhe e zgjedhjes.

<b>TRE KANDIDATURAT E PRESIDENTIT</b>		
DUHEN MINIMALISHT 3 KANDIDATË / PËR VEND		
<b>07.02.2018</b>	<b>07.02.2018</b>	<b>04.03.2018</b>
ARTA VORPSI	BESNIK MUÇI	ARTA VORPSI
BESNIK MUÇI	REGLETA PANAJOTI	ELSA TOSKA
ELSA TOSKA		FIONA PAPAJORGJI
REGLETA PANAJOTI		MARSIDA XHA FERLLARI
<b>TRE KANDIDATURAT E PARLAMENTIT</b>		
DUHEN MINIMALISHT 3 KANDIDATË / PËR VEND		
<b>12.02.2018</b>	<b>24.12.2018</b>	<b>04.03.2019</b>
ARTA VORPSI	NUK KA KANDIDATË	ARTA VORPSI
BESNIK MUÇI		FIONA PAPAJORGJI
ELSA TOSKA		ELSA TOSKA
<i>Shenim: Disa kandidatë vijojnë të presin vendimmarrjen e Gjykatës Administrative lidhur me vendimmarrjen e KED pers kualifikimin e tyre</i>		

Nga ana tjetër gara për në Gjykatën Kushtetuese është bërë edhe më interesante nga vendimi i Gjykatës Administrative për të detyruar KED të rimarrë në proces vlerësimi kandidaten Zhaklina Peto. Më parë, dy kandidatë të tjerë të skualifikuar, Kristaq Traja dhe Vasil Bendo, bënë padi në Gjykatën Administrative por nuk arritën të kenë sukses në pretendimet e tyre. Shtatë kandidatë të tjerë i janë drejtuar Gjykatës dhe janë në pritje të vendimmarrjes me akuzat e tyre ndaj KED.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese ka nxitur thellimin e krizës politike dhe të konflikteve institucionale në vend. Një prej çështjeve më me rëndësi në axhendën e saj mbetet debati mbi dekretin e Presidentit dhe vlerësimin për ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019, si dhe nisma e mazhorancës për shkarkimin e Presidentit, si dhe shkarkimin e kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës. Gjithashtu në pritje janë disa akte të tjera me rëndësi politike, përfshirë së paku pesë nisma të mazhorancës të kaluara në parlament pa firmën e Presidentit të Republikës. Po ashtu, në axhendën e saj janë animime të ndryshme të konflikteve midis institucioneve si dhe çështje që kanë të bëjnë sa me të drejtat e njeriut aq edhe me standardet e shtetit të së drejtës në Shqipëri.



Mungesa e Gjykatës Kushtetuese dhe përgjegjësitë për këtë situatë janë komentuar gjerësisht nga i gjithë spektri politik e mediatik në vend. Për qeverinë, mungesa e saj nuk përbën problem dhe është çështje e përkohshme, kurse për opozitën mungesa e saj minon tërësisht reformën në drejtësi. Faktori i tretë, ai ndërkombëtar, në përpjekje për të mos lejuar rënien e besimit publik tek reforma, është përpjekur të theksojë sa rëndësinë e Gjykatës aq edhe ta konsiderojë krizën e saj si “mungesë kuorumi të përkohshëm”.

Vlen të theksohet në këtë histori se askush, përfshirë ekspertët shqiptarë e të huaj, të cilët realizuan reformën në drejtësi më 2016, nuk kanë pranuar përgjegjësi për krizën e rëndë të shkaktuar në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë. Referuar publikimeve mbi reformën rezulton se asnjë prej tyre nuk e kishte parashikuar krizën (me përjashtim të Komisionit të Venecias), - një tregues kritik i nivelit të ekspertizës dhe i dominimit të nevojës për vetting mbi nevojën për standarde më të larta të shtetit të së drejtës.

Alibia e sotme është e njëjtë: nuk ishte parashikuar shkarkimi i të gjithë anëtarëve apo kjo e fundit është tregues se Gjykata ka qenë një institucion i korruptuar dhe i paaftë profesionalist. Në fakt, ka pasur dhe ka një konsensus të heshtur midis të gjithë ekspertëve që merren me tranzicionin tonë, - sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese ka pasur gjithnjë interferime politike, por nuk ka qenë as institucion i korruptuar dhe as një bashkim i individëve të paaftë profesionalistë. Disa prej vendimeve të saj, përfshirë edhe ai i Marrëveshjes së Detit, mbi 22 vendime kundërshtuese ndaj qeverive apo edhe vendimet për korrektimin e ligjeve bazë të vetë reformës në drejtësi, ishin dhe mbeten vendime kurajoze, profesionale dhe pa ndonjë prapavijë korruptive, -momente krenarie në historinë e kushtetutshmërisë në Shqipëri. Brenda tyre ka pasur gjithnjë 2-3 anëtarë të promovuar nga politika pa merita të veçanta dhe që pa integritetin që duhet të ketë një gjyqtar në Kushtetuese, ndaj edhe bilanci i shkarkimeve apo dorëheqjeve të anëtarëve të saj duhet lexuar në kuadër të fazës kur iu bë vettingu, si dhe faktorëve të tjerë ndikues në proces.

### 3.8. GJYKATA E LARTË, PA PRURJE TË REJA DHE ME TË DELEGUAR NGA APELI

Gjykata e Lartë thelloi krizën e saj më 2019, duke “humbur” edhe dy anëtarë të tjerë, një gjyqtar dhe vetë kryetarin e Gjykatës. Aktualisht Gjykata ka vetëm një anëtar me mandat nga 19 që duhej të ketë, si dhe vetëm 7 nga 30 këshilltarë. Numri i çështjeve që pret të gjykohet prej saj ka kaluar 32,000 dhe kosto financiare e vonës sidomos në dosjet me efekte financiare ka kaluar limitet e parashikuara.

Procesi për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është më i vonuar sesa për Gjykatën Kushtetuese dhe në shtator pritet të fillojë verifikimi vetëm i kandidatëve që vijnë nga komuniteti i juristëve. Situata e jashtëzakonshme e krijuar në Gjykatën e Lartë u zgjidh me një formulë krize dhe jo kushtetuese, - delegimin e dy gjyqtarëve të Apelit në vendimmarrjet e Gjykatës së Lartë. Delegimi i vendosur nga KLGJ dhe i mbështetur nga ekspertët e misionëve ndërkombëtare, u bë i nevojshëm sidomos për vendimet e ekstradimeve, por në thelb, është dhe mbetet një akt pa mbështetje në paketën e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, pra një eksperiment i ri me reformën në drejtësi.

Një listë prej më shumë se 22 emrash kanë kandiduar për pjesën e Gjykatës që vjen nga juristët jo gjyqtarë dhe brenda shtatorit është premtuar verifikimi i të dhënave të tyre, cili/cila plotëson kriteret formale për të mbetur në garë për Gjykatën e Lartë. Në listën e emrave të bërë publikë nga media, me përjashtime të vogla, kanë konkurruar një numër i madh individësh pa ndonjë CV profesionale të atillë që mund të përlligjë pritshmëritë dhe cilësitë që kërkon një anëtar i Gjykatës në Lartë në kuadrin e reformës së re të drejtësisë.



Ky është një sinjal negativ dhe një shenjë se sfida për të plotësuar vendet në Gjykatën e Lartë do të jetë shumë më e gjatë sesa është pritur edhe në variantin më optimist.

### 3.9. KED, ROL PARËSOR PËR GJYKATËN KUSHTETUESE DHE INSPEKTORIN

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) u bë headline në media gjatë periudhës mars-gusht 2019, për shkak të rolit të tij të rëndësishëm në procesin e seleksionimit të kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vetë institucioni vazhdimisht është ankuar për mungesë stafi dhe mjetesh mbështetës, - të cilat duhet të ofrohen nga Gjykata e Lartë. Për shkak të volumit të madh të punës, por edhe për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar në vetë Gjykatën e Lartë një sërë detyrimesh të KED që lidhen me organizimin dhe transparencë nuk janë përmbushur plotësisht ose tërësisht. Të tilla janë edhe problematikat në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të KED, por edhe një sistem më efikas e i besueshëm i transparencës publike në lidhje me vendimmarrjet e tij.

### 3.10. KANDIDATËT NË SISTEMIN E RI: PESË PROBLEME THELBËSORE

Për shkak të kriterëve në përvojë pune dhe elementëve të tjerë të kufizimeve për kandidim, për të gjitha vendet vakante, përfshirë vendet për në Gjykatën Kushtetuese, për Gjykatën e Lartë apo për Inspektor të Drejtësisë, - numri i individëve që i përmbush ato është i kufizuar.

Nga ana tjetër, besimi tek procesi nuk ka qenë asnjëherë në nivel të tillë sa të bëhet nxitës për të gjithë individët me integritet profesional. Gjatë 2018 dhe 2019 disa herë misionet perëndimore, sidomos Ambasada e SHBA ka bërë thirrje publike inkurajuese për kandidatët me integritet për të kandiduar për vendet vakante në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë. Nxitja e tyre dha efekte pozitive, por të pamjaftueshme për të gjetur kandidatët e mjaftueshëm për vendet vakante në dispozicion.

Duke ndjekur me vëmendje listat e kandidatëve për postet vakante, sidomos për Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe Inspektorin e Drejtësisë, bien në sy pesë tipare kryesore:

- E para, pothuajse të njëjtit emra konkurrojnë për më shumë se një post, madje në rastin e vendit për në Gjykatën Kushtetuese, konkurrojnë njëherësh për 3-4 vende vakante, përfshirë edhe për gjyqtar me mandat të plotë ose të pjesshëm në Gjykatën Kushtetuese. Kandidatë për në Gjykatën Kushtetuese konkurrojnë edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, madje ka raste edhe për Gjykatën e Lartë apo për Gjyqtar në Gjykatën e Strasburgut.
- E dyta, rreth 60% e kandidatëve janë ish prokurorë të përgjithshëm, ish kryetarë të gjykatës së lartë, ish ministra drejtësie, ish drejtues në nivele të larta të gjyqësorit apo prokurorisë, etj. Një pjesë e tyre e kanë mbyllur mandatin e parë (ish) me një bilanc kritik dhe negativ publik, ndaj kurajo e tyre për të pretenduar edhe postet e reja drejtuese në sistemin e ri të drejtësisë përbën një fenomen që meriton analizë.
- E treta, ka një listë të gjatë të të deleguarve partiakë në institucione, përfshirë të zgjedhur partiak në KQZ apo anëtarë të forumeve partiake, ka një listë të punonjësve të administratës publike, kryesisht



drejtorë drejtorie apo sekretarë të përgjithshëm, të cilët kandidojnë tashmë për pozita të pavarura në sistemin e ri të drejtësisë.

- E katërta, ka një listë individësh që kanë konkurruar edhe për KPK dhe KPA, më pas për KLP e KLGJ dhe që çdo herë janë rrëzuar për mos plotësim kriteresh dhe që përsëri janë në garë sa herë njoftohet një garë e re. Nëse vendimet e mëparshme të rrëzimit të tyre do të ishin bërë publike, sidomos kur janë rrëzuar për shkak të probleme të mëdha me pasurinë apo dëshmi serioze të paaftësisë profesionale, së paku do ishin kursyer kohë dhe energji për rivlerësim periodik të tyre sa herë hapen vende të reja në sistemin e ri të drejtësisë.
- Së fundi, ka një listë individësh që nuk kanë probleme me CV e tyre, janë teknikisht korrekt me kriteret dhe për pasojë, kalojnë lehtësisht filtrat e testimit, ndërkohë që nëse shikohet me vëmendje CV e tyre profesionale, nuk kanë pasur ndonjë arritje të veçantë në karrierën e tyre. Për shembull, për shkak të vetë natyrës së Gjykatës Kushtetuese duhet të ishte kriter thelbësor detyrimi që çdo kandidat aspirant të ketë botime profesionale në karrierën e vet, libra studimorë ose artikuj studimorë të verifikueshëm. Nga të dhënat paraprake, edhe nga kandidatët e kaluar tashmë nga KED, vetëm gjysma e tyre kanë edhe një CV reale profesionale tek asaj formale. Për pjesën tjetër pyetja mbetet e hapur: si do të mundet një gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shkruajë vendime profesionale me referime nga praktikat perëndimore dhe me logjikë të avancuar të normave kushtetuese, kur për shembull, në karrierën e tij/saj nuk gjendet asnjë gjurmë e ndonjë punimi apo kërkimi shkencor profesional?

### 3.11. KONFLIKTI I INTERESIT? MUNGESË STANDARDESH DHE PRAKTIKASH

Gjatë 2019 janë konstatuar raste të shumta kur zyrtarë të lartë të institucioneve të reja të drejtësisë, përfshirë nga KLP dhe KLGJ, etj, kanë kryer veprime ose janë bërë pjesë e veprimeve të cilat mund të cilësohen gjendje në konflikt interesi profesional. Institucionet ende nuk kanë krijuar praktika solide të sjelljes institucionale dhe të evitimit të çdo gjendjeje në konflikt interesi, ndërkohë që në një situatë emergjence, siç është nevoja për jetësimin e shpejtë të institucioneve të reja, elementë të tillë kritikë nuk marrin vëmendjen e merituar as publike dhe as institucionale.

Gjatë një debati në një aktivitet në mjediset e Kuvendit (prill 2019) një prej drejtuesve të institucioneve të reja të drejtësisë citoi së paku katër herë me vlerësim të lartë drejtuesit e Ministrisë së Drejtësisë. Rrethana të tilla ku një institucion i pavarur vlerën lart organin politik që de facto mbetet kërcënues i pavarësisë së tij, janë praktikë normale tek ne, ndërkohë që vetë institucioni, në raportimin vjetor në parlament ankohet se ekzekutivi nuk ka përmbushur në kohë e me cilësi disa nga detyrimet e tij.

- A lidhet arsyeja e falënderimeve ndaj titullarit politik me faktin se anëtarë të rëndësishëm në familjen e tij/saj janë njëherësh punonjës në varësi të Ministres?
- A përbën konflikt interesi kur një anëtar i KLP shoqëron në një analizë apo aktivitet publik një prej kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm që duhen testuar nga vetë KLP?
- A përbën konflikt interesi rasti kur në delegacione politike të ministrave përfshihen edhe anëtarë e drejtues të KLGJ apo KLP apo kur individë me lidhje familjare me vetë strukturat emërohen në administratën mbështetëse të tyre?

Këto e raste të ngjashme apo të tjera meritojnë një trajtim serioz e institucional në fazën e re ku ndodhet reforma dhe institucionet tashmë të ngritura apo ato që pritet të ngrihen.



### 3.12. SPAK, “SHPËTIMI” I REFORMËS NË DREJTËSI?

---

SPAK mbetet premtimi i madh dhe shihet gjerësisht si instrumenti që do të sjellë ndryshime të rëndësishme për reformën dhe luftën ndaj korrupsionit në vend. Sipas ligjit dhe premtimit fillestar të KLP, SPAK do të duhej të ishte jetësuar në fillimin e pranverës, por premtimet optimiste pa pasur në konsideratë nevojën që të gjithë kandidatët e SPAK të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit (vettingun), tregojnë edhe njëherë se janë pa baza.

Në rrethanat aktuale SPAK ka një listë kandidatësh, të cilët po trajtohen nga organet e vettingut, ndërkohë që asistencë ndërkombëtare ka kohë që është në pritje të krijimit të saj.

Lista emërore e prokurorëve kandidatë për SPAK tregojnë se: Enkelejda Millonaj, Arben Kraja, Klodian Braho dhe Elida Karçini kanë kaluar me sukses vettingun në KPK dhe nuk ka ankimim ndaj tyre në KPA. Për pjesën tjetër procesi i vettingut ende nuk ka nisur në KPK për të vijuar më pas në KPA nëse do të ketë animime. Ened Nakuçi ka kaluar vettingun, por KPK ka rekomanduar hetime të tjera lidhur disa problematika të tij. Besnik Muçi ka kaluar me sukses në KPK, por çështja e tij është ankimuar në KPA dhe në shtator është seanca mbi rastin e tij. i njëjti kandidat ka kaluar edhe provën e KED për kandidat për në Gjykatën Kushtetuese. Në pritje të KPA është edhe prokurorja Kajana, e cila fitoi në KPK, por vendimi u ankimua nga IKP.

Pyetja është, sa anëtarë duhet të kalojnë vettingun për të pasur vendimmarrje të SPAK? Ka pasur ide, përfshirë edhe nga zyrtarë drejtues të KLP, që e quajnë funksionale SPAK edhe me anëtarë jo të plotë, ndërkohë që Kushtetuta parashikon përcaktimin se SPAK nuk duhet të ketë më pak se 10 prokurorë.

### 3.13. KOMISIONI I MONITORIMIT NË KUVEND, “NJË ZGJIDHJE E DËSHTUAR”

---

Kuvendi, në zbatim të ligjit ngriti edhe Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (Komisioni Pavarur). Komisioni, ndër funksionet kryesore, do të duhet të krijonte një axhendë monitoruese, nxitëse dhe raportuese për ecurinë e reformës në drejtësi në aspektin e jetësimit të institucioneve të reja, afateve, standardeve dhe problematikave.

Edhe në raportet e mëparshme është konstatuar se pritshmëritë ndaj këtij Komisioni ishin të mëdha, por vlerësimet janë kritike dhe shumë larg mundësive dhe nevojave të reformës. Komisioni hartoi raporte, të cilat periodikisht i bëri publike në faqen e internetit të Kuvendit, si dhe bashkëpunoi me Komisionin e Ligjeve në Kuvend, megjithatë në tërësi Komisioni nuk arriti të përmbushë përgjegjësitë e tij dhe as të ketë ndikim në procesin e jetësimit të institucioneve të reja të drejtësisë. Ai më shumë ndoqi axhendë në funksion të mbështetjes së axhendës politike të Komisionit të Ligjeve sesa një axhendë në funksion të mbështetjes së sfidave të reformës në drejtësi.

Vlerësimi më i qartë lidhur me bilancin e këtij Komisioni është dhënë në parlament nga ish kreu i Komisionit të Reformës në Drejtësi, Fatmir Xhafaj, i cili gjatë diskutimit të tij në seancën e 8 majit 2019, pranoi se “*ka edhe problematika që lidhen me mungesën e shpejtësisë dhe qartësisë në vendimmarrje, me një koordinim jo*



shume efikas në procesin e ngritjes së institucioneve, cilësinë e funksionalitetit të Këshillave të reja dhe sidomos të KLP, nga mbështetja e vonuar infrastrukturore e logjistike për institucionet e reja, mosmiratimin ende të ndryshimeve të imponuara nga vendimmarrjet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese etj të tilla”. Duke iu referuar Kuvendit Xhafaj shtoi se “padyshim kuvendi ka rolin e vet në këtë proces pasi ai ka detyrimin e koordinimit dhe kontrollit përkatës në kufijtë e parashikuar nga kuadri ligjor përkatës. Komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë kuvendit, si një mekanizëm për të lehtësuar këtë proces dhe për ta ruajtur atë nga ndikimet e jashtme, në vlerësimin tim duhet konsideruar një zgjidhje e dështuar si për sa i përket autoritetit ashtu edhe aftësisë së tij për ta përmbushur këtë mision të vështirë”.

### 3.14. “POLI I DREJTËSISË DHE DISA TË FAKTE TË TJERA RRETH TIJ

Më 22 korrik 2019 në një ceremoni zyrtare u përurua godina e quajtur “Poli i Drejtësisë”, - ku do të vendosen mjediset e punës të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës. Vendimi i Qeverisë për marrjen e godinës së ndërtuar për Shkollën e Avokatisë dhe kalimin për organet e reja të drejtësisë i dha zgjidhje problemit dy vjeçar të debatit mbi ambientet e punës për këto organe. Në dhjetor 2018 një tjetër vendim i Këshillit të Ministrave që vendosur që godina e quajtur “Komanda e Doktrinave dhe Stërviçjes” do të ishte selia e re e KLP, KLGJ dhe ILD. Në plane ishin edhe godina të tjera ushtarake në kompleksin tek ish-Shkolla e Bashkuar, ku ndodhet edhe Ministria e Mbrojtjes apo mjediset e ARRSH përballë teatrit të ri “Turbina”.

Lajmi për “Polin e Drejtësisë” është i mirëpritur në aspektin e zgjidhjes administrative, gjithsesi ka dy detaje interesante të cilat u injoruan në këtë rast. E para, asnjë nga oratorët në ceremoninë zyrtare, përfshirë Ministri i Drejtësisë apo Ambasadorë të vendeve të rëndësishme, nuk cituan në deklaratimet e tyre faktin se nuk kemi të bëjmë me një godinë të re të dedikuar drejtësisë, por me marrjen nga qeveria të një godine të dedikuar Shkollës së Avokatisë.

Për më tepër, në deklaratat zyrtare të institucioneve ekzekutive u përcoll lajmi në mënyrë të tillë, për të krijuar idenë se qeveria ka ndërtuar godinën për institucionet e reja dhe kështu, ajo e ka mbajtur premtimin e saj, - vlerësim që nuk është i vërtetë në dy komponentët e këtij deklarami. Detaji i dytë, në publik nuk u dha asnjë e dhënë zyrtare mbi vlerën e godinës, përfituesit e marrëveshjes me qeverinë, etj, pra mungoi transparenca, - një element me rëndësi që qëndron në themel të reformës në drejtësi.

### 3.15. KEKUPTIMET “NDËRKOMBËTARE” DHE VETTINGU

Për të kuptuar problematikat që shpesh krijohen nga “të huajt” në drejtim të realitetit shqiptar, le të ilustrojmë rastin e subjektit të rivlerësimit A.M. Personit iu parashtrua nga vëzhguesi ndërkombëtar dyshimi serioz për fshehje të pasurisë mbi shpenzimet e 26 udhëtimeve të tij të kryeja jashtë shtetit me automjetin e tij. Kur lexon se një subjekt rivlerësimi ka udhëtuar 26 herë jashtë vendit me makinë çdo qytetar që e dëgjon, menjëherë mendon se kemi të bëjmë me një prej milionerëve të drejtësisë, pra me individ që bën jetë luksoze sa zgjedh të udhëtojë periodikisht jashtë shtetit.

Në Shqipëri ky përcaktim ka shpjegim tjetër. Kur lexon se me “jashtë shtetit” nënkuptohet pika e kalimit kufitar në Morinë (Kukës) dhe Qafë - Morinë (Tropojë) kushdo që e njeh Shqipërinë, e di se kemi të bëjmë me 6 deri në 13 udhëtime nga Tirana në Tropojë, por që për lehtësi udhëtimi prej më se një dekade çdo udhëtar shkurton kohën e udhëtimit për në Tropojë duke kaluar me makinë përmes Kosovës, pra nga



“jashtë shtetit”. Ka raste kur në kufi ka katër kontrolle (dy për hyrje dhe dy për dalje) ose dy kontrolle. Pra, në thelb nuk kemi të bëjmë me 26 udhëtime jashtë shtetit, por me 6 deri në 13 udhëtime “brenda shtetit”, nga Tirana në Tropojë dhe anasjelltas!

### 3.16. RËNIA E NDIKIMIT TË SHOQATAVE TË GJYQTARËVE

Gjatë periudhës 2014-2017 dy shoqatat e gjyqtarëve, “Unioni i Gjyqtareve” dhe “Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve” ishin mjaft aktive në debatet publike lidhur me drejtësinë, si dhe në të gjitha fazat e përgatitjes dhe të miratimit të reformës në drejtësi. Ato ishin aktorë institucionalë, të referueshëm dhe lanë gjurmë edhe në nismat ligjore të adresuara në Gjykatën Kushtetuese.

Pas vitit 2017 pesha dhe roli i tyre publik ka rënë ndjeshëm. Gjatë vitit 2019 pati vetëm tre deklarime publike në emër të tyre, kryesisht pa ndonjë fokus me rëndësi për reformën dhe së fundi, me padinë në Gjykatën Administrative ndaj kryeministrit dhe MPJ lidhur me vendimin për heqjen e pasaportave të shërbimit për gjyqtarët.

Në tërësi, që nuk ka nisur procesi i vettingut nuk kemi asnjë rast të vetëm kur shoqatat kanë analizuar dhe kanë mbajtur qëndrim mbi standardet e procesit të vettingut, nuk ka rast kur ato të kenë pranuar publikisht se subjekte të rivlerësimit të shkarkuara meritojnë të shkarkohen (as në rastin kur një anëtar i Gjykatës së Lartë rezultoi i dënuar në Itali), sic nuk kemi pasur ndonjë qëndrim alternativ mbi vendimet e marra nga strukturat e reja të drejtësisë, përfshirë KLP e KLGJ, as në rastet kur dukshëm ka pasur cenim të të drejtave të komunitetit të tyre.

### 3.17. VETTING, KARRIERË DHE ... POLITIKË?

Kolegji Zgjedhor është organi kryesor vendimmarrës për të gjitha çështjet që lidhen me proceset zgjedhore në vend. Kolegji përzgjidhet sipas përcaktimeve të bëra nga Kodi Zgjedhor dhe luan një rol të rëndësishëm dhe shpesh përcaktues në vendimmarrjet e rëndësishme politike që burojnë nga zgjedhjet. Një rol të tillë Kolegji e luajti edhe në zgjedhjet lokale 2019, përmes shqyrtimit të padisë së një subjekti elektoral ndaj vendimeve të KQZ. Në thelb, vendimi pati rëndësi të madhe sepse lidhej indirekt me vlerësimin për legjitimitetin e procesit zgjedhor të iniciuar nga mazhoranca dhe të kontestuar nga Presidenti i Republikës përmes disa dekreteve, përfshirë dekreti për anulimin e datës së zgjedhjeve.

Kolegji mori vendim 3 vs 2 vota, në favor të KQZ dhe për rrjedhojë, të legjitimitetit të procesit zgjedhor. Vendimi pati impakt të rëndësishëm politik dhe u mbështet fuqishëm nga mazhoranca dhe shumica e deleguar e saj në KQZ. Pas publikimit të detajeve të vendimit rezultoi se rezultati ka qenë jashtëzakonisht i ngushtë dhe se vetëm një votë ka bërë diferencën. Nga të dhënat rezultoi se votat pro KQZ ishin gjyqtarët Artur Malaj, Shkëlqim Mustafa dhe Tomor Skreli, pakica në vendimmarrje ishin gjyqtarët Ridvan Hado dhe Lindita Sinanaj.

Më shumë sesa brendësia e aktit merr vlerë edhe një element tjetër, si p.sh, ndikimi i mundshëm politik në karrierën e gjyqtarëve që përbëjnë Kolegjin Zgjedhor. Një prej votave përcaktuese pro mazhorancës ishte gjyqtari Malaj, i cili ka kaluar me sukses KPK, por vendimi është ankimuar dhe pret të përballet në shtator me vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Njëherësh zoti Malaj është kandidat për Inspektor i



Lartë i Drejtësisë, i konfirmuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me mbështetje të fortë kryesisht nga grupe me ndikim politik brenda mazhorancës në pushtet.

Nga ana tjetër, ka pasur raste kur vendime të gjyqtarëve të ndryshëm në çështje me ngarkesë politike, janë përdorur nga politika në atë formë dhe sasi, sa u kanë veshur gjyqtarëve identitet politik të caktuar. Ja një shembull ilustrues: në tetor 2018 Gjykata Tiranë dha një vendim në lidhje me padinë e kryetarit të bashkisë Tiranë Erjon Veliaj ndaj këshilltarit të PD Tiranë Akil Kraja lidhur me akuzën e këtij të fundit se bashkia ka rritur çmimin e ujit në Tiranë. Gjykata e konsideroi fajtor këshilltarin dhe vendosi që ai ti paguajë një dëmshpërblim moral prej 1 milion lekësh kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Ky ishte një rast unik i vendimmarrjes së gjykatës për akuza politike midis mazhorancës dhe opozitës. Ndaj vendimit të pazakontë pati reagim nga nivelet më të larta të politikës. Kryeministri Rama e vlerësoi lart vendimin e Gjykatës dhe paralajmëroi se ka 12 padi të tjera të njëjta kundër opozitës. Kryetari i bashkisë Tiranë, eksponent i lartë i PS gjithashtu deklaroi mbështetje maksimale për trupën gjyqësorë që mori vendimin. Nga opozita reagoi kryetari i PD Basha, sipas të cilit *“as Edi Rama as kamikazja e tij e korruptuar Regleta Panajoti që dënon për shpifje opozitarin Akil Kraja sepse denoncoi rritjen e çmimit të ujit nga vrasësi i Ardit Gjoklajt, nuk do na e mbyllin dot gojën. Fundi i tyre është i afërt dhe i ngjashëm me atë të diktaturës”*.

Duhet të rikujtojmë se në korrik 2019 gjyqtarja Regleta Panajoti është kualifikuar nga KED si kandidate potenciale për në Gjykatën Kushtetuese. Në rrethanat e reja mund të imagjinohet lehtësisht vlerësimi që opozita e djathtë dhe qeveria kanë për kandidaten për Gjykatën Kushtetuese, - e para duke e konsideruar atë “kamikazë” dhe “të korruptuar” dhe e dyta duke e konsideruar atë “të aftë” dhe “të ndershme”. Në dy rastet, dy palët, sipas praktikave të njëjta të aplikuara gjatë tranzicionit, në fakt vetëm sa kanë dëmtuar ndjeshëm imazhin dhe integritetin e gjyqtarës, të cilën njëra palë e konsideron kundërshtarë dhe tjera mbështetëse. Imagjinohet lehtë komentet që mund t’i bëhen zonjës në fjalë në rast se zgjidhet në Gjykatën Kushtetuese.





## 4. VETTINGU 2019: BILANCI, PROBLEME DHE GJETJET KRYESORE

---

Procesi i rivlerësimit (vettingut) vijon të mbetet prioritarë në vendimmarrjet e KPK, KPA, ONM apo IKP, si edhe me ndikim të madh në reformën në drejtësi. Seancat dëgjimore kanë marrë natyrën e serialeve të telenovelave, ku çdo ditë ka kronika e lajme mbi individë që shkarkohen, kalojnë, etj, si dhe mbi pasurinë e tyre personale. Një numër organizatash të shoqërisë civile bëjnë monitorimin e vendimmarrjes në KPK dhe KPA, si dhe ka media dhe organizata që i paraprijnë seancave me trajtim profesional të së dhënave për secilin kandidat.

Bilanci i vettingut ka rëndësi për të kuptuar trendin e vendimmarrjes dhe gjendjen e sistemit të drejtësisë, si dhe për të vlerësuar standardet e deritanishme dhe sfidat për përmirësime në të ardhmen. për shkak se një numër çështjesh janë paralajmëruar tashmë se do të shkojnë në Gjykatën Evropiane në Strasburg, është e rëndësishme analiza e procesit të rivlerësimit edhe nga këndvështrimi shqiptar. ISP e ka bërë dhe vijon ta bëjë periodikisht këtë detyrë.

Në raportet tona analizojmë bilancin e vettingut, tiparet kryesore të tij, si dhe bëjmë klasifikimin dhe tabela me të dhëna të shumta dhe të ndërthurura të vendimmarrjeve, të punës së vetë Komisionerëve, të rolit të ONM dhe të aspekteve të tjera të vettingut në drejtësi. Të tilla të dhëna gjenden edhe në këtë raport, gjysma e tyre vijnë si risi në krahasim me raportet e mëparshme.

### 4.1. DSIK, ILDKPI DHE STANDARDET KRITIKE TË VLERËSIMIT

---

Për të gjitha rastet e rivlerësimit një prej burimeve kryesore të referimit është informacioni që vjen nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Deklarimit të Pasurisë, ILDKPI. Janë të shumta rastet kur raportet e DSIK dhe ILDKPI kanë shërbyer si material për shkarkimin e një subjekti të rivlerësimit, pra kanë marrë vlerë e peshë të rëndësishme në vendimmarrjen finale sidomos të KPK.

Në fakt, një analizë e detajuar e referimeve që kanë ardhur nga DSIK dhe ILDKPI tregon se raportet nuk janë bazuar në një praktikë standard dhe i njëjti organ ka lëshuar raporte e vlerësime të kundërta për të njëjtin subjekt rivlerësimi. Për shembull, në rastin e një prokurori në Kavajë, DSIK fillimisht solli raport pozitiv, pastaj një raport negativ për rrëzon të parin. Në këtë rast KPK e konsideroi raportin e dytë të “pabazuar në prova dhe ligj”. Praktika të tilla të DSIK gjenden në të paktën 12 raste të tjera të procesit të vlerësimit, në të cilat ka pasur pasoja për vetë subjektet e rivlerësimit. Të tilla praktika kontradiktore gjenden vazhdimisht edhe në vlerësimet e ofruara nga ILDKPI.

Lidhur me DSIK, një sërë zhvillimesh jashtë reformës në drejtësi, siç ishte rasti i kandidatit për bashkinë Shkodër, - një ish zyrtar i lartë me certifikatë sigurie, si dhe e disa zyrtarëve të tjerë të lartë të ekzekutivit, gjithashtu me certifikatë sigurie, - kanë nxjerrë në pah mangësitë e dukshme në relacionet, vlerësimet dhe standardet që aplikon DSIK për subjektet për të cilat kërkohet vlerësim dhe certifikim i tyre. A mundet që e njëjta problematikë të jetë reflektuar edhe në rastet e vettingut në drejtësi? Nuk ka asnjë garanci se standardi ka qenë i ndryshëm dhe shpresa e vetme mbeten informacionet e ardhur nga kanale diplomatike apo shërbime partnere, të cilat mund të jetë më të sakta sesa vetë informacionet e ardhura nga DSIK.



## 4.2. PROBLEMATIKA ME REFERIMET E VENDIMEVE TË VETË KPK

---

Problemet dhe mungesa e një standardi të njëjtë vlerësimi në raste të ndryshme të rivlerësimit nuk ka qenë vetëm një konstatim i jashtëm (shoqëria civile dhe media), por edhe një konstatim i brendshëm nga gjyqtarë, prokurorë dhe subjekte të ndryshme të rivlerësimit. Për ilustrim po ju sjellim shembullin e një subjekti, i cili e kaloi vettingun dhe tashmë është kandidatë për në Gjykatën Kushtetuese (R.P).

Në seancën dëgjimore të saj në KPK, kur relatori dhe anëtarët e tjerë të trupës ngritën shqetësime e dyshime rreth të ardhurave financiare të saj, kryesisht për të ardhurat e deklaruar cash në familje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në të paktën dy raste KPK ka mbajtur qëndrim mbështetës ndaj rasteve identike me të. Ajo citoi rastin e kryetarit të KED Ardian Dvorani dhe të kreut të Gjykatës Administrative Eriol Roshi, si raste kur KPK u njohu deklarimet e tyre për të ardhurat cash në familje apo mbështetjen financiare të dhënë nga anëtarët e tjerë të familjes, duke pasur mungesë deklarimi likuiditetesh.

## 4.3. RASTI “SEVDARI”, PASOJAT NË KLP, ONM OPONENCË KPA-SË

---

Kur KPA mori vendim për shkarkimin e prokurores Antoneta Sevdari, vendimi i mor me 4 vota pro dhe 1 votë kundër, ku pakicë ishte ish prokurorja e përgjithshme, Ina Rama. Relator i çështjes ishte Luan Daci dhe anëtarët e tjerë ishin Sokol Çomo, Rezarta Shuetz dhe Ardian Hajdari. I vetmi rast kur ONM ka bërë raport publik kundër vendimit të KPA është rasti i shkarkimit të prokurores Sevdari. Vëzhguesi ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot e konsideroi jo-proporcional vendimin e Kolegjit të Posaçëm të për të shkarkuar anëtarin e KLP-së Antoneta Sevdari, si dhe e kritikoi vendimin si interpretim i gabuar i ligjit duke krijuar praktikën e “deklarimit të pamjaftueshëm”.

Raporti i tij krijoi një praktikë të re, sipas të cilës një vëzhgues ndërkombëtar paraqet mendim publik pakice dhe mban qëndrim publik për një çështje rivlerësimi në KPA. Siç dihet, vendimet e KPA janë përfundimtare, ndaj në raste të tilla mendimi i pakicës, sidomos kur vjen nga ekspertiza ndërkombëtare, merr vlerë të posaçme nëse çështje shqyrtohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Megjithatë kjo praktikë e re duket se krijon mbivendosje dhe se KPK e KPA nuk mbeten organet e vetme vlerësuese, por ONM merr një rol tjetër më të zgjeruar sesa ishte paramenduar në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016.

Rasti “Sevdari” krijoi një problematikë të re edhe në KLP. Ajo përbën anëtarin e dytë të KLP që humbet mandatin për shkak të vettingut dhe për pasojë, mbetet një problematikë e hapur dhe e diskutueshme procesi i zëvendësimit, roli i Prokurorisë dhe Prokurores së Përgjithshme në këtë procedurë, si dhe efektet e vendimmarrjeve të ardhura nga anëtarë që vetë vetingu i nxorri jashtë sistemit. Ndërkohë së paku dy anëtarë të tjerë të KLP vijojnë të jenë në gjykim në KPA, pa përcaktuar ende legjitimitetin e mandateve të tyre si anëtar të “qeverisjes” së re në Prokurori.

## 5. KPK, BILANCI DHE PROBLEMATIKA TË FUNKSIONIMIT

---

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është instanca e parë e procesit të rivlerësimit dhe mori rëndësi veçanërisht të madhe në fazën e parë të nisjes së procesit të vettingut. Duke qenë një strukturë e re, pa



përvojë të mëparshme dhe kryesisht me anëtarë pa njohje të gjerë publike, me prurje të reja dhe me asistencë mbështetëse nga institucionet ndërkombëtare, pritej që KPK të ishte shumë më tepër sesa një instancë e vettingut. KPK mund e duhej të ishte një strukturë, e cila përveç vendimmarrjeve në lidhje me rivlerësimin krijon edhe standarde dhe metodikë vlerësimi, e cila të mbetet e qëndrueshme për subjektet e tanishme dhe të ardhshme të rivlerësimit.

Fillimisht KPK shënoi sukses dhe bëri headline në media dhe në jetën publike me shkarkimet e bujshme të disa prej anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Me këto akte KPK rrëzoi mitin e paprekshmërisë dhe krijoi mjedisin e nevojshëm për një proces rivlerësimi të thelluar dhe horizontal për të gjitha subjektet. Suksesi i saj fillestar ishte aq i madh në vendimet për shkarkim sa modeli i vettingut në drejtësi u konsiderua zgjidhje edhe për vettingun në polici dhe më pas edhe në politikë.

Më kalimin e muajve dhe problemeve që u krijuan me krizën në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Inspektorin e Lartë dhe më pas edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, KPK e ndryshoi disa herë listën prioritare të procesit të rivlerësimit. Kriza e krijuar krijoi edhe dilema nëse do të kishte qenë më efektive të nisej vettingu në formë proporcionale në të gjitha nivelet apo të niste siç nisi, nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

Problemi tjetër me të cilin KPK u përball ishte ndjekja e standardeve të vettingut. Kushtetuta parashikon tre standarde, tre kritere vlerësimi, por në më shumë se 30% të rasteve KPK mori vendime bazuar në të vlerësimin e vetëm një standardi, kryesisht pasurisë. Lënia jashtë hetimit të standardeve të tjera mund të sjellë pasoja disproporcionale për subjektet e rivlerësimit dhe hap debat mbi nevojën që Shqipëria të ketë një ILDKPI të tyre, kur tashmë prej vitesh ILDKPLI është institucioni që merret me pasurinë e zyrtarëve dhe ka të gjithë instrumentet e nevojshme të verifikimit. Suksesi i KPK në hetimin e pasurisë ishte njëherësh konfirmim i dështimit të ILDKPI në të njëjtin funksion e përgjegjësi.

KPK në 19 raste të vlerësimit të suksesshëm, pra konfirmimit në detyrë të subjekteve, pranoi e deklaroi në vendim se në treguesit e aftësive profesionale subjektet kishin nivel "minimal" të profesionalizmit, - një tregues se jo gjithnjë i ndershmi është edhe i aftë dhe anasjelltas, kur reforma në drejtësi në thelb krahas ndershmërisë ka në themel të saj profesionalizmin. Në vetëm një rast KPK vendosi që një subjekt rivlerësimi duhet të ndërpresë detyrën dhe të kalojë 1 vit studime e trajnim të thelluar pranë Shkollës së Magjistraturës. Në 18 rastet e tjera nuk pati vendim të tillë.

Gjatë vitit 2019 në drejtim të KPK ka pasur akuza dhe deklarime të shumta kritike, shpeshherë nga subjekte të rivlerësimit, por edhe nga shoqëria civile, media, institucione ndërkombëtare, etj, se procesi i vendimmarrjes aty ka devijuar shumë nga standardet e nisura të procesit të vettingut dhe se detaje të parëndësishme për reformën, siç janë shorti i seancave dëgjimore, trupa gjyqësore, verifikimi i të dhënave nga institucionet, vlerësimi i ankesave nga qytetarët, etj, - shpeshherë marrin vlerë dhe ndikojnë në vetë produktin e vendimeve, sidomos në cilësinë e tij.

Fakti se deri më tani ka disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilat kanë rrëzuar vendimmarrjet e KPK dhe megjithatë kjo e fundit nuk ka reaguar për të përmirësuar standardet dhe metodikën e vlerësimit aktual dhe asnjë prej komisionerëve nuk ka pranuar përgjegjësi edhe kur ka rezultuar se vendimi i tyre ka qenë i gabuar, - është një argument kritik dhe një devijim nga parimet mbi të cilat do të duhej të realizohej reforma në drejtësi.




Në të paktën dy raste, - një pretendim për falsifikim të të dhënave të deklaruara nga një prej komisionerëve në KPK dhe një pretendim se njëra prej anëtarëve të trupës ka marrë vendim mbi subjektin e rivlerësimit pa qenë prezent në seancë dhe madje pa qenë në Shqipëri, - ende nuk kanë marrë përgjigje publike nga KPK dhe madje nuk ka të dhëna as se janë trajtuar, - një devijim gjithashtu nga standardet e transparencës, të cilat duhet të jenë në themel të jetësimit të reformë në drejtësi.

### 5.1. KPK, DERI NË 20 MUAJ KOHË PËR VENDIM NDAJ SUBJEKTEVE TË VETINGUT


Praktika e vendimmarrjeve në KPK në shumicën e rasteve kanë tejkaluar kohën e parashikuar fillimisht të zgjatjes së procesit të rivlerësimit. Konkretisht, tabela më poshtë jep rastet e subjekteve, për të cilat vettingu në nivelin e parë të kontrollit, në KPK, ka marrë 16 deri në 20 muaj kohë.

Referuar të dhënave të KPK mbi periudhën nga hedhja e shortit dhe deri tek vendimi final i tij, mbi subjektet e rivlerësimit, rezulton se ka diferenca të mëdha për subjekte të ndryshme. Për shembull, për të marrë një vendim lidhur me subjektin K.Selita, kreu i Gjykatës Administrative të Apelit KPK kërkoi rreth 20 muaj kohë, shumë më tepër sesa për çdo subjekt tjetër rivlerësimi. Ka emra të tjerë në listën e subjekteve që kanë kërkuar 16 deri në 18 muaj kohë për një proces rivlerësimi, i cili sipas ligjit duhet të mos zgjaste më shumë sesa 60 – 90 ditë, pra 2-3 muaj.

Midis atyre më me shumë zvarritje në vlerësimin e KPK janë disa drejtues prokurorie, si në Kavajë, Krujë, Përmet, Shkodër, etj. Ndërkohë, në listën e subjekteve që kanë kaluar më shpejt vetingun në KPK rekord janë disa anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, përfshirë të dorëhequrit Imeraj (Gjykata Kushtetuese) dhe Llalla (ish Prokurori i Përgjithshëm). Ata morën vetëm 3 muaj kohë për vlerësim, ndërkohë që tre subjekte të tjera përfshirë një anëtar në Gjykatën Kushtetuese dhe një në Gjykatën e Lartë morën gjithashtu vetëm 4 muaj kohë.




Referuar tabelës jepen rastet kur procesi i vettingut është finalizuar nga KPA, pra ka kaluar fazën e vlerësimit nga KPK dhe më pas përmes ILD ose direkt si individ, është ankimuar në KPA dhe është trajtuar edhe aty për vendimmarrje. Në tabelë janë përfshirë vetëm rastet që tashmë janë mbyllur, pra ka një vendim të formës së prerë nga KPA dhe subjekti ka të drejtë të paraqitet vetëm në Gjykatën e Strasburgut. Siç shihet nga të dhënat e tabelës, për gjashtë raste procesi i vettingut ka zgjatur 20 muaj, për një rast ka zgjatur 19 muaj dhe për dy raste të tjera ka zgjatur 18 muaj. Vlen të theksohet se procesi ka zgjatur për 20 muaj edhe për raste kur përfshihen subjekte të rivlerësimit, të cilat që në fillim të procesit u penalizuan, apo kur edhe për raste të cilat nuk përbëjnë subjekte me rëndësi në hierarkinë e sistemit aktual apo të mëparshëm të drejtësisë.




## 5.2. KPK, 36% SUBJEKTE TË SHKARKUARA VS 42% TË KONFIRMUARA

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka publikuar vazhdimisht shortin prioritarë të saj lidhur me listat e individëve që do të jenë subjekte të rivlerësimit. Disa prej subjekteve kanë dhënë dorëheqje, disa janë tërhequr nga procesi, dhe disa kanë hyrë në procesin e rivlerësimit.



Në total, referuar këtyre listave prioritare, rezulton se deri në gusht 2019, KPK ka vendosur në 36% të rasteve shkarkimin e subjekte e të rivlerësimit ndaj 42% konfirmimin e tyre në detyrë. Në 20% të rasteve subjektet e rivlerësimit i janë shmangur vetingut duke paraqitur dorëheqje, në 1% të rasteve ka pasur pezullim të procesurës së vetingut dhe në 1% të rasteve në ndërprerje të procesit të vetingut.

Në lexim numerik, në total janë 189 raste vendimesh të kaluara deri më tani nga KPK. Prej tyre, 80 raste janë për konfirmim në detyrë dhe 69 raste janë për shkarkim nga detyra. Për 38 raste KPK ka marrë vendime për ndërprerje të procesit të vettingut për shkak të dorëheqjes së subjektit në rivlerësim, si dhe ka një rast ndërprerje të praktikës dhe një rast tjetër kur individi pezullohet për një periudhë 1 vjeçare duke sugjeruar përfshirjen e tij në programet e trajnimit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës.




### 5.3. SHPËRNDARJA E ÇËSHTJEVE NË KPK: NGA 62 NË 34 RASTE PËR PERSON

Tabela ilustron të gjitha çështjet e trajtuara deri tani në KPK që prej fillimit të procesit të vettingut dhe deri më 26 gusht 2019. Siç shihet, duke përjashtuar një prej komisionerëve, e cila për arsye shëndetësore nuk ka qenë pjesë aktive e procesit, në 11 rastet e tjera ka ndarje disproporcionale të angazhimit të komisionerëve.

Sipas tabelës ka komisionerë me 60-62 raste në ngarkim (si relator, anëtar apo kryetar trupe), ndërkohë që për të njëjtin numër komisionerësh ka ngarkesë deri në 50% më të vogël, nga 34 në 42 çështje në total. Komisionerët më të ngarkuar me çështje janë Pamela Qirko me 62 raste, Roland Ilia me 60 raste, Lulzim Hamitaj dhe Etleda Çiftja me nga 59 raste. Kryetarja e KPK Genta Tafa (Bungo) ka 56 raste, gjithsesi një numër i madh edhe për shkak të funksionit të saj të dyfishtë në KPK, për të vijuar më pas me komisionerët e tjerë me nga 34 raste (Zhegu) dhe 40-42 raste (Shuli, Bekteshi dhe Komiçi).


### NUMRI I ÇËSHTJEVE TË GJYKUARA NË KPK SIPAS KOMISIONERËVE



#### 5.4. KPK, NDARJE E PËRGJEGJËSISË SË RELATORËVE NË GJYKIME


Funksioni më i rëndësishëm në procesin e rivlerësimit është qenia relator në një çështje, pra edhe përgjegjës për analizën paraprake dhe më pas parashtrimin e mbrojtjen e të dhënave në seancën dëgjimore me subjektin e rivlerësimit. Nga të dhënat e KPK nga nisja e procesit të vettingut dhe deri në gusht 2019, rezultojnë se numrin më të madh të çështjeve si relator e ka pasur komisioneri Roland Ilia (21 raste), ndjekur nga Etleda Çiftja (20 raste), Xhensila Pine, Genta Tafa dhe Pamela Qirko (me nga 19 raste). Ndërkohë ngarkesën më të vogël si relatorë, duke përjashtuar komisioneren Faskaj (arsye shëndetësore), e kanë pasur komisionerët Olsi Komiçi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu (me nga 13 raste).

#### ANËTARËT E KPK SI RELATORË



## 5.5. KOMISIONERËT MË “LIBERALË” GJATË VETINGUT NË KPK

Nga të dhënat e mbledhura në vendimmarrjet e KPK gjatë periudhës nga nisja e vettingut dhe deri në fundin e muajit gusht 2019, rezulton se midis komisionerëve ka pasur përqindje të ndryshme të rasteve të vendimeve konfirmuese në detyrë.



Konkretisht, komisionerja Pamela Qirko në 66% të rasteve ka pasur konfirmime në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, kryetarja e KPK Genta Tafa (Bungo) ka pasur konfirmime në detyrë në 63% të rasteve të gjykuara, Firdes Shuli ka pasur konfirmime në detyrë në 56% të rasteve të gjykuara, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine vijojnë me nga 55 dhe 54% konfirmime, etj. Komisionerët më me pak konfirmime në detyrë, përveç rastit Faskaj, është Olsi Komiçi me vetëm 44% konfirmime në detyrë dhe Lulzim Hamitaj e Etleda Çiftja me na 48% dhe 49% konfirmime në detyrë të subjekteve të rivlerësimit.

## 5.6. KOMISIONERËT MË TË ASHPËR NË VETTING (KPK)

Tabela e rasteve të komisionerëve më liberalë në vendimmarrjet konfirmuese ilustron edhe të anasjelltë, komisionerët me nivelin më të lartë dhe më të ulët të vendimmarrjes për shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, vendimet më të shumta për shkarkime të subjekteve të rivlerësimit i takojnë komisionerëve Olsi Komiçi dhe Lulzim Hamitaj, përkatësisht me 56% dhe 52%. Komisionerët me përqindjen më të ulët të vendimmarrjes për shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit janë Pamela Qirko me 34% dhe Genta Tafa (Bungo) me 37% e të gjitha rasteve.



## VENDIME PËR SHKARKIME (NË %) SIPAS KOMISIONERËVE




Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të balancuar dhe krahasuese të dhënat për komisionerët, përqindjet në rastet e vendimeve të tyre për konfirmime në detyrë apo për shkarkime të subjekteve të rivlerësimit. Nga tabela janë hequr rastet e vlerësimit për subjektet që kanë dhënë dorëheqje, pra rastet e ndërprerjes së procesit të vettingut, pasi rezultati në këto raste është formal dhe i paracaktuar nga vetë praktikantët e vettingut.

VENDIMET E KOMISIONERËVE 2018-2019 (NË %) LIDHUR ME SUBJEKTET E RIVLERËSIMIT		
KOMISIONERËT	KONFIRMIME	SHKARKIME
ALMA FASKAJ	43%	57%
BRUNILDA BEKTESHI	51%	49%
ETLEDA ÇIFTJA	49%	51%
FIRDES SHULI	56%	44%
GENTA Tafa (BUNGO)	63%	37%
LULZIM HAMITAJ	48%	52%
OLSI KOMIÇI	44%	56%
PAMELA QIRKO	66%	34%
ROLAND ILIA	53%	47%
SUELA ZHEGU	52%	48%
VALBONA SANXHAKTARI	55%	45%
XHENSILA PINE	54%	46%
TOTAL	54%	46%



Referuar rasteve, të cilat janë ankimuar nga Institucioni i Komisionerëve Publike (IKP), me ose pa rekomandim të ONM, rezulton se numri më i madh i çështjeve i përket komisionerëve Roland Ilir (12 raste) dhe Olsi Komiçi (10 raste).

Në këto raste komisionerët kanë qenë relatorë, kryetarë apo anëtarë të vendimeve në KPK. Në vijim të listës, sipas tabelës ilustruese, janë Pamela Qirko me 9 raste, Genta Tafa me 8 raste, Lulzim Hamitaj me 7 raste, etj. Në fundin e tabelës me numrin më të vogël të rasteve të ankimuar në KPA rezultojnë komisionerët Etleda Çiftja (2 raste), Suela Zhegu (3 raste) dhe Valbona Sanxhaktari e Xhensila Pine me 4 dhe 5 raste.


<b>KOMISIONERËT DHE RASTET E VENDIMEVE ME SHUMICË VOTASH (KPK)</b>				
<i>VENDIME 2 VS 1</i>	<i>KONFIRMIME</i>	<i>K-RELATOR</i>	<i>SHKARKIME</i>	<i>SH-RELATOR</i>
<b>ALMA FASKAJ</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>BRUNILDA BEKTESHI</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>ETLEDA ÇIFTJA</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>
<b>FIRDES SHULI</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>GENTA Tafa (BUNGO)</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
<b>LULZIM HAMITAJ</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>OLSI KOMIÇI</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
<b>PAMELA QIRKO</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>ROLAND ILIA</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>SUELA ZHEGU</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>VALBONA SANXHAKTARI</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
<b>XHENSILA PINE</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>1</b>
<i>TOTAL</i>	<i>27</i>	<i>9</i>	<i>18</i>	<i>6</i>

Tabela ilustron të gjitha rastet e vendimmarrjeve me shumicës votash nga ana e komisionerëve të KPK. Në kolona të ndryshme janë ndarë të dhënat për secilin komisioner, në sa raste ka qenë pjesëmarrësve në vendimet me shumicës votash (2 vs 1 votë), në rastet kur komisioneri ka qenë relator tek konfirmimet dhe relator tek rastet e shkarkimeve.

Siç shihet nga tabela, në konfirmime janë së paku 9 raste, ku relatorë kanë qenë Bekteshi ( 2 raste), Shuli (2 raste), si dhe Bungo, Hamitaj, Qirko, Zhegu e Pine (nga 1 rast). Në vendimmarrjet e KPK për shkarkimet e subjekteve të rivlerësimit, numri i relatorëve është 6 (për vendimet e deritanishme të publikuara), ku dy raste ka vetëm komisionieri Roland Ilia.



### KOMISIONERËT SIPAS RASTEVE TË ANKIMUARA NGA IKP



#### 5.7. KOMISIONERËT NË “PAKICË”: BILANCI NË VENDIMET PËR SHKARKIM NË KPK

Lidhur me rastet e vendimeve me shumicë votash (2 vs 1) për shkarkimet e subjekteve të rivlerësimit, rezulton se në gjashtë raste KPA ka marrë tashmë vendim për katër prej tyre, kurse dy raste të tjera vijojnë të jenë në proces.

BILANCI I “PAKICËS” NË VENDIMET E SHKARKIMIT NË KPK		
PAKICË - SHKARKIMET	ECURIA NË KPA	SUBJEKTET
GENTA Tafa (BUNGO)	NEGATIV	(XHOXHAJ)
XHENSILA PINE	NEGATIV	(BROCI)
VALBONA SANXHAKTARI	NEGATIV	(ZENELI)
ROLAND ILIA	NË PROCES	(YLLI)
VALBONA SANXHAKTARI	NË PROCES	(HAJRO)
VALBONA SANXHAKTARI	NEGATIV	(HOXHA)

Në tërësi në gjashtë rastet mendimi i pakicës është përfaqësuar tri herë nga komisionerja Valbona Sanxhaktari dhe nga një herë nga komisionerët Genta Tafa, Roland Iliad he Xhensila Pine. Pas vendimeve në KPA rezulton se ky i fundit nuk i ka dhënë të drejtë katër rasteve të vendimeve të pakicës, përkatësisht, nga një herë komisionerëve Genta Tafa (Bungo) dhe Xhensila Pine dhe dy herë komisioneres Valbona



Sanxhaktari. Referuar mendimeve të shumicës në katër rastet e mësipërme të mbyllura tashmë nga KPA, rezulton se kanë pasur të drejtë në arsyetimin e tyre komisionerët Etleda Çiftja (4 raste), Xhensila Pine (2 raste), Brunilda Bektashi (2 raste), si dhe Valbona Sanxhaktari (1 rast), Alma Faskaj (1 rast), Olsi Komiçi (1 rast), Roland Ilia (1 rast).

## 5.8. KOMISIONERËT NË PAKICË: BILANCI NË VENDIMET KONFIRMUESE NË KPK

Në vendimet me shumicë votash (2 pro dhe 1 kundër) për konfirmim në detyrë janë në total 9 raste të vendimeve të KPK.

<b>BILANCI I "PAKICËS" NË VENDIMET KONFIRMUESE TË KPK</b>		
<i>PAKICË - KONFIRMIMET</i>	<i>ECURIA NË KPA</i>	<i>SUBJEKTET</i>
<b>ETLEDA ÇIFTJA</b>	NEG-NUK PATI ANKIMIM	(LARA)
<b>ETLEDA ÇIFTJA</b>	NEG-NUK PATI ANKIMIM	(SHTUNGZA)
<b>OLSI KOMIÇI</b>	NEG-NUK PATI ANKIMIM	(BELULI)
<b>OLSI KOMIÇI</b>	POZ-NË PROCES	(SELITA)
<b>SUELA ZHEGU</b>	NEG-NUK PATI ANKIMIM	(GOXHI)
<b>XHENSILA PINE</b>	POZITIV	(DEDJA)
<b>XHENSILA PINE</b>	POZ-NË PROCES	(MEDJA)
<b>VENDIMI JO PUBLIK</b>	NEG-NUK PATI ANKIMIM	(PANAJOTI)
<b>VENDIMI JO PUBLIK</b>	POZ-NË PROCES	(MADANI)

Pavarësisht se midis komisionerëve ka pasur debat dhe vlerësime të ndryshme është interesante fakti se në pesë raste (pra në 55% të totalit) Komisioneri Publik dhe ONM nuk kanë bërë rekomandim dhe as proces ankimi të vendimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Konkretisht, me një votë më shumë janë konfirmuar në detyrë, subjektet e rivlerësimit Lala, Shtrungza, Beluli, Goxhi dhe Panajoti, kjo e fundit kandidat e miratuar nga KED për në Gjykatën Kushtetuese, e megjithatë IKP nuk ka ushtruar ankimi ndaj vlerësimit të tyre. Në rastet e tjera të vendimeve konfirmuese me shumicë votash (Dedja, Medja, Selita, Madani), komisioneri publik ka ushtruar të drejtën e ankimit në KPA dhe në një prej tyre, KPA ka dhënë vendim shkarkimi, pra rrëzimin e vendimit të KPK, ndërkohë që për tre rastet e tjera procesi vijon në KPA.

Lidhur me bilancin e deritanishëm të mendimeve të pakicës në vendimet konfirmuese në KPK, rezulton se mendimi i pakicës (Xhensila Pine) në rastin e subjektit Dedja, ka rezultuar i saktë në vendimin final të KPA, ndryshe nga votat e dhëna nga komisionerët Valbona Sanxhaktari dhe Roland Ilia. Në rastet e tjera ende nuk ka një vendim final, gjithsesi fakti se disa vendime janë ankimi në KPA do të thotë se trendi është për vendim pozitiv të pakicës, kurse në rastin kur vendimet nuk janë ankimi atëherë mendimi i pakicës mund të konsiderohet negativ (i pasuksesshëm). Në rastin e vendimit me trend pozitiv janë komisionerët Xhensila Pine e Olsi Komiçi, kurse në rastin e vendimeve me trend negativ (nuk janë ankimi) janë dy rastet e vendimit në pakicë të komisioneres Etleda Çiftja, një rast për komisionerin Olsi Komiçi dhe një rast për komisioneren Suela Zhegu. Për dy raste të tjera ende nuk janë bërë publike vendimet dhe për pasojë, as mendimet e pakicës.



## 6. KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT: BILANCI, RISI DHE PROBLEMATIKA

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) është organi kryesor i vendimmarrjeve në procesin e rivlerësimit. Vendimet e tij janë të formës së prerë dhe Kolegji luan rolin e një Gjykate Kushtetuese, por edhe Gjykatë speciale dedikuar reformës në drejtësi. Mandati i saj është i barabartë me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe përbërja e tij reflekton sa suksesin personal të individëve në Kolegji aq edhe konsensusin politik të pranverës 2017. Kolegji është gjendur nën presion për krijimin e standardeve të gjykimit, mbi të cilat do të duhej të vepronte edhe KPK në vendimmarrjen dhe metodikën e tij të hetimeve. Kolegji është përpjekur ta luajë këtë rol, megjithatë ndikimi i tij tek KPK është e mbetet minimal. KPK vijon të marrë vendime me të njëjtën metodikë edhe në rastet kur KPA ka vendosur që vendimet e saj kanë qenë të gabuara.

Kolegji u përball më 2018-2019 me dy raste të kërkesës për largimin e një anëtari nga trupa vlerësuese, me pretendimin e konfliktit të interesit. Në dy rastet KPA i dha të drejtë ankimesit dhe gjyqtari i KPA hoqi dorë nga pjesëmarrja në trupin gjykues, pavarësisht vendimit të mëparshëm me short. Në tërësi Kolegji ka trupë përbërëse shumë më profesionale sesa KPK, megjithatë disa prej anëtarëve të tij ose nuk kanë pasur në të kaluarën raste të gjykimit dhe të përvojës në gjykatë/prokurori, ose kanë qenë edhe vetë objekt masash penalizuese, përfshirë nga KLD. KPA e sotme përbën një zgjidhje emergjence në rrethanat ku u ndodh vendi më 2017, por disa prej anëtarëve të tij falë përvojës dhe profesionalizmit kanë investuar shumë në rritjen e prestigjit dhe të besimit publik tek KPA.


### 6.1. KOLEGJI I APELIT: VETËM 1 NGA 33 SUBJEKTE GJYKIMI SHËNOI SUKSES

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) ka dhënë deri më tani 33 vendime, lidhur me kërkesa për rivlerësim të vendimeve të KPA nga Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP) si dhe nga animime të vetë subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar nga vendimet e KPK.

Në tërësi, KPA ka vendosur shkarkimin e subjekteve (përfshirë konfirmimin e shkarkimeve nga KPK) në 85% të rasteve (28 raste në total) në gjykim. Në 9% të rasteve ka vendosur ndalimin e individëve të dorëhequr për marrje postesh drejtuese në sistemin e ri nga 5 në 15 vjet, na varësi nga subjekti dhe problematika specifike që lidhet me të. Në 3% të rasteve ka vendosur pushimin e çështjes duke shpallur moskompetencën dhe në 3% gjithashtu ka vendosur pushimin e çështjes.


Subjekti i rivlerësimit Nertila Kosova, është i vetmi rast kur ILD ka bërë ankimim të vendimit të KPK, por gjatë seancave të KPA ai ndryshoi qëndrim dhe kërkoi lënie në fuqi të vendimit konfirmues të KPK. Sipas ILD *“Komisioneri Publik vlerëson se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje, në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, provoi nevojën që për raste të ngjashme, kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë, merita dhe kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik të jetë alternativ kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, pasi sikundër ky rast dëshmoi, të gjitha shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, në referencë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, gjetën përgjigje nga rreth 70 prova të reja, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor”.*





## 6.2. EFIKASITETI I GJYQTARËVE TË KPA, BILANCI SI RELATORË

Relatorët e çështjeve kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit, dhe sidomos në kohëzgjatjen e procesit të rivlerësimit për subjekte nën vetting. Tabela e punës së relatorëve në një farë mase tregon edhe tabelën e efikasitetit të punës së tyre gjatë periudhës së deritanishme të vettingut.




Referuar të dhënave nga KPA, rezulton se dy anëtarë të Kolegjit, kryetarja Natasha Mulaj dhe ish Prokurorja e Përgjithshme Ina Rama kanë rezultatet më të lartë, duke mbyllur 50% të rasteve që janë nën përgjegjësinë e tyre si relatores. Shifra 50% është maksimale, ndërkohë që proceset vazhdojnë dhe ngarkesa për komisionerët është jashtëzakonisht e lartë, - e njëjtë me punën e 12 komisionerëve publikë në KPK. Në vendin e tretë me nivelin më të lartë të efikasitetit në vendimmarrjen si relator është anëtari tjetër i Kolegjit, Ardian Hajdari me 42%, ndjekur nga Rezarta Schuetz, Luan Daci dhe Albana Shtylla me nga 40%. Komisioneri i Apelit me treguesit më minimalë të efikasitetit në çështjet ku është shortuar si relator i çështjes, është Sokol Çomo me 33% e të gjitha rasteve në shqyrtim.

### 6.3. KPA: KOHA PËR VENDIM, NGA 4 NË 8 MUAJ

E lidhur me tabelën e efektivitetit është edhe tabela me të dhënat e komisionerëve në KPA lidhur me kohën mesatare që merr relativizmi i një çështje në përgjegjësinë e tyre.


Sipas tabelës, rezulton se për dy gjyqtarët, Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo relatimi i një çështje në seancë merr mesatarisht 8 muaj kohë, koha më e gjatë në nivel KPA-je. Për gjyqtarin Luan Daci relatimi i një çështjeje merr 5,6 muaj kohë, për gjyqtaren Albana Shtylla relatimi merr 4,7 muaj kohë, për gjyqtaren Ina Rama relatimi i një çështjeje merr 4,5 muaj kohë dhe për dy komisionerët e tjerë, Kryetaren Natasha Mulaj dhe anëtarin Ardian Hajdari relatimi i një çështjeje merr vetëm, 4,1 muaj kohë ose për afërsisht sa gjysma e kohës që konsumojnë dy gjyqtarët e tjerë, Çomo e Schuetz.



#### 6.4. KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT E RRËZOI KPK NË 21% TË RASTEVE


Një nga aspektet e analizës së reformës në drejtësi është analiza e vendimmarrjeve nga dy strukturat, sidomos nga KPA në raport me vendimmarrjen e KPK. Kolegji mbetet instanca e fundit e vendimit mbi subjektet e rivlerësimit, ndaj vendimet e saj kanë efekt të menjëhershëm dhe janë sprovë edhe për vetë funksionimin e sistemit të ri.

Referuar të dhënave të deritanishme (deri në gusht 2019), rezulton se Kolegji ka marrë vendime të ndryshme nga KPK për të njëjtin subjekt rivlerësimi, në 21% të rasteve. Shifra është e larta, rreth 1 në 5 gjykime, - një tregues i disnivelit të gjyimit të KPA ndaj KPK dhe për pasojë edhe i dobësive të vendimmarrjeve të ardhura nga KPA në raste të tilla. Rastet më të njohura të vendimmarrjeve të Kolegjit kundër vendimeve konfirmuese të KPK janë rasti i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, rasti i kryetarit të Gjykatës së Lartë, rasti i një anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe katër raste të tjera që lidhen me prokurorë e gjyqtarë të rëndësishëm, përfshirë edhe anëtarë të Këshillin e Lartë të Prokurorisë.



#### 6.5. VENDIME UNANIME NË KPA? VETËM NË 68% TË RASTEVE

Në dallim nga KPK ku numri i vendimeve me shumicë votash është minimal, në KPA rreth një e treta e vendimeve janë marrë me vota të ndara, pra në shumicë dhe në pakicë.






Referuar tabelës së përgjithshme të vendimmarrjes së KPA, 68% e vendimeve kanë pasur votë unanime, ndërkohë që 22% e vendimeve kanë pasur së paku një gjyqtar në pakicë dhe në 10% të vendimeve ka pasur ndarje të votave, 3 në favor dhe 2 në pakicë.

## 6.6. INA RAMA DHE REZARTA SCHUETZ, 4 HERË NË PAKICË NË KPA

Mendimi i pakicës në KPA ka vlerë jo vetëm për cilësinë e vendimmarrjes, por edhe për të demonstruar rëndësinë profesionale që anëtarët e KPA i japin procesit të vlerësimit nga ana e tyre. Në rastin shqiptar mendimi në pakicë, sidomos në çështje me sensibilitet të lartë publik është edhe tregues integriteti, por në rastet e njohjeve personale apo mjedisit të jashtëm ndikues votat në pakicë mund të jenë edhe çështje pragmatizmi.

Në disa prej çështjeve të bujshme, përfshirë rastin “Sevdari” apo “Xhoxhaj” ka pasur mendime pakice me vlerë studimore mbi metodologjinë dhe vlerësimin rrënjësor të procesit të vettingut. Ka raste të tjera, si në rastin e dorëheqjeve, ku ndarja pakicë – shumicës nuk merr ndonjë rëndësi të veçantë.



Konkretisht, referuar vendimeve të gjyqtarëve si pakicë në KPA rezultojnë se Ina Rama pati mendim pakice në vendimmarrjet që lidhen me subjektet e rivlerësimit A.Xhoxhaj E.Sadiku, F.Hoxha dhe A.Servdari. Gjyqtarja Rezarta Schuetz ishte në pakicë në vendimmarrjet lidhur me subjektet e rivlerësimit Besim Treshnjeva, Edmond Islamaj, Mirela Fana dhe Artan Lazaj. Për rastin Lazaj dhe Fana ishte në mendim pakice edhe gjyqtari Ardian Hajdari, kurse për rastin e subjekteve të rivlerësimit Adriatik Llalla e Sulejman Tola ishte në mendim pakice gjyqtari Sokol Çomo. Gjyqtarja Albana Shtylla ishte në pakicë në rastin e ish Prokurorit të Përgjithshëm.

## 7. IKP DHE ONM: BILANCI I RIVLERËSIMIT

Institucioni i Komisionerëve Publikë ka një rol gjithashtu të rëndësishëm në garantimin e transparencës dhe të procesit të rregullt ligjor në gjykimin e çështjeve në KPK dhe në KPA. Duke qenë institucion nominal, me vetëm dy komisionerë, por duke qenë edhe institucioni që merr për shqyrtim ankimmimet që vijnë nga ekspertët ndërkombëtarë, IKP ka pasur dhe ka vend të rëndësishëm në integritetin e procesit të rivlerësimit.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) është organ tashmë kushtetues për sa kohë është përfshirë në aneksin e ndryshimeve kushtetuese 2016 për reformën në drejtësi. Roli zyrtar i ONM është vetëm vëzhgimi, pra monitorimi i proceseve të rivlerësimit dhe e drejta e tyre për të rekomanduar tek Komisionerët Publikë ankimimet e vendimeve të KPK lidhur me subjektet e rivlerësimit. Që në krye të herës ONM ka pasur dhe ka një status jo publik, nuk ka faqe interneti për aktivitetin apo CV e anëtarëve të tij dhe se rekomandimet mund të lexohen vetëm në faqen e IKP.

### 7.1. IKP, VETËM 13% ANKIMIME NDAJ KPK NË KOLEGJIN E APELIT

Të dhënat e deritanishme dëshmojnë se në totalin e çështjeve që janë trajtuar nga KPK, vetëm 13% e rasteve janë ankimuar nga IKP në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA). Nga këto raste rezulton se nga 189 çështje janë ankimuar vetëm 24 çështje.



Problematika kryesore që lidhet me IKP nuk ka të bëjë vetëm me shifrat (sa vendime të KPK janë dërguar në KPA), por ka të bëjë me të kundërtën, - sa vendime të njëjta të KPK me ato janë dërguar në KPA nuk janë dërguar, pra nuk janë apeluar nga ana e IKP. Në totalin e vendimeve të KPK ka pasur çështje me të njëjtat problematika dhe vendime që kanë pasur të njëjtën metodologji dhe të njëjtën analizë vendimmarrëse, megjithatë IKP nuk ka bërë për të njëjtat raste të njëjtat praktika, pra nuk ka ushtruar ankimim. Natyrisht që është e drejtë ligjore e IKP të marrë vendim rast pas rasti, megjithatë një reformë me integritet kërkon aplikim standardesh të njëjta për të gjitha subjektet.

Gjithashtu është interesante të studiohen dhe analizohen dokumentet e ankimeve të IKP në KPA, për të krahasuar këndvështrimin e KPK, IKP dhe KPA për të njëjtat prova dhe të njëjtat burime.

TOTALI I PROCESIT TË ANKIMIMEVE NË KPA		
ANKIMUAR / JO ANKIMUAR	RASTET	NË %
<b>ANKIMUAR NË KPA</b>	<b>24</b>	<b>13%</b>
<b>NUK JANË ANKIMUAR</b>	<b>125</b>	<b>87%</b>
<b>TOTALI I VENDIMEVE</b>	<b>189</b>	<b>100%</b>

Nga të dhënat krahasuese të nismave për adresimin e vendimeve të KPK në Kolegj, rezulton se në 38% të rasteve ankimimi ka ardhur me rekomandim e kërkesë të ONM dhe në 62% të rasteve ankimimi ka ardhur me nismë të vetë komisionerëve publikë. Në rastet më të bujshme të ankimit nga ONM bëjnë pjesë ish krerët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, kurse në rastet më të bujshme të ankimit të ardhur nga vetë IKP bën pjesë edhe prokuroria e krimeve të rënda Donika Prela, apo ish Prokurori i Përgjithshëm dhe disa ish anëtarë të rëndësishëm të sistemit gjyqësor. Në një rast (deri tani) ankimimi i IKP doli i pasaktë dhe vetë institucioni u tërhoq gjatë shqyrtimit në KPA, kurse pjesa më e madhe e rasteve të tjera ankimimet, sidomos ato të iniciuara nga ONM, janë konfirmuar nga KPA.






Referuar dy komisionerëve publikë, komisioneri Darjel Sina ka kryer 42% të animimeve dhe të përfaqësimit të IKP në proceset e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndërkohë që komisioneri tjetër Florian Ballhysa ka volum më të lartë ankimesh dhe pjesëmarrjes në procese, me 58% të rasteve.

Ka vetëm një rast kur ONM ka dhënë rekomandim përpara publikimit të vendimit nga KPK. Konkretisht, KPK, me shumicë votash vendosi me 1 korrik 2019 konfirmimin në detyrë të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë në Kavajë. Vendimi nuk është publikuar ende (26 gusht 2019) në faqen zyrtare të KPK megjithatë, më 26 korrik, misioni ndërkombëtar (ONM) vendosi rekomandimin e animimit të vendimit të KPK tek IKP.

Pra, megjithëse në vendimin e datës 1 korrik përcaktohet detyrimi për njoftimin e vendimit brenda 30 ditëve dhe të drejtën e animimit 15 ditë pas njoftimit të vendimit, vendimi nuk është publikuar, por 27 ditë më vonë ONM ka bërë animimin dhe deri në 26 gusht (rreth një muaj nga rekomandimi i ardhur nga ONM) ende nuk ka një vlerësim dhe vendim nga Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP).

## 7.2. ONM DHE BILANCI I ANGAZHIMIT NË MONITORIMIN E VETTING

Me ecurinë e procesit të vettingut është pranuar jo zyrtarisht se roli i ONM është më shumë më i madh dhe më thelbësor sesa monitorimi. Sjellja e tyre në seancat dëgjimore dhe sidomos pyetjet apo vlerësimet që ata u bëjnë në këto seanca subjekteve të rivlerësimit janë përcaktuese dhe me ndikim të madh në vendimin final që merr trupa e Komisionerëve të Pavarur të Kualifikimit. Ndërhyrjet e tyre janë gjithnjë lajm për median dhe komentet e tyre janë shpeshherë përcaktuese edhe për kurbën që po ndjek ecuria e vettingut në reformën në drejtësi.



Referuar të dhënave zyrtare (për vendimet e publikuara deri më 26 gusht 2019), rezulton se komisionerët ndërkombëtarë kanë qenë të pranishëm në të gjitha rastet e vendimeve për shkarkim apo konfirmim nga KPK. Deri tani janë 131 vendime të publikuara me prezencën e tyre, ndërkohë që një rekomandim për ankimim prej ONM bazohet në një vendim ende të publikuar nga KPK.

Referuar emrave të përfaqësuesve ndërkombëtarë rezulton se vetëm dy vëzhgues ndërkombëtarë, amerikani Leonardo dhe kroati Hrvatin nuk kanë ushtruar ende të drejtën e rekomandimit pranë IKP ndaj vendimeve të dhëna nga KPK. Të gjithë të tjerët kanë lëshuar rekomandime publike, ku numrin më të madh e ka vëzhguesi holandez Hans Kijstra me 3 rekomandime dhe vëzhguesve tjetër holandeze mia Roessingh me dy rekomandime. Vëzhguesit e tjerë kanë gjithashtu nga një rekomandim. Në total ONM ka bërë 9

rekomandime, të cilat janë pranuar nga IKP, nga të cilat tre raste janë konfirmuar nga KPA, pra i është dhënë e drejtë ONM. Megjithatë ende nuk ka ndodhur që KPA të ketë marrë një vendim kundër një rekomandimi të dhënë nga ONM.

Në proceset gati formale të subjekteve të rivlerësimit që kanë dhënë dorëheqje nga vettingu dhe nga pozita në sistemin e drejtësisë, vlen të theksohet se vëzhguesit e ONM kanë marrë pjesë në vetëm 5 raste nga 38 në total.

<b>BILANCI I ROLIT TË VËZHguesVE NDËRKOMBËTARË – GUSHT 2019</b>			
VËZHguesIT E ONM - GUSHT 2019	SHKARKIME	KONFIRMIME	ANKIMIME
<b>BRANKO HRVATIN</b>	8	6	<b>0</b>
<b>ELKA ERMENKOVA</b>	7	9	<b>1</b>
<b>FERDINANDO BUATIER DE MONGEOT</b>	6	8	<b>1</b>
<b>HANS KIJLSTRA</b>	5	7	<b>3</b>
<b>JOHN LEONARDO</b>	8	11	<b>0</b>
<b>MARIE TUMA</b>	9	9	<b>1</b>
<b>MIA ROESSINGH</b>	9	9	<b>2</b>
<b>THEO JACOBS</b>	7	13	<b>1</b>
<b>TOTAL</b>	<b>59</b>	<b>72</b>	<b>9</b>
<i>Shënim: nuk janë përfshirë 5 raste të proceseve të dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit</i>			

### 7.3. ZBARDHJA E VENDIMEVE, NEVOJA PËR UNIFIKIM TERMASH/EMRASH

Një nga defektet e vendimeve të publikuara nga KPK, nuk janë vetëm nevoja për ndërhyrje në së paku 10 raste për të bërë redaktim, plotësim e sqarim vendimesh me vendime të tjera, por edhe problematika në emërimin e saktë të proceseve, masave dhe sidomos të emrave. Për shembull, referuar vëzhguesve ndërkombëtarë, në vendimet e KPK të paktën dy prej tyre shfaqen me dy forma të ndryshme.

Për shembull, vëzhguesi Hans Kijlstra del në disa vendime me emrin Hans Peter Kijlstra duke mos e pasur të qartë emrin zyrtar në një dokument kaq të rëndësishëm zyrtar. Gjithashtu vëzhguesja Mia Roessingh shfaqet në disa vendime të KPK me emër më të zgjeruar, Mia LHE Roessingh-Bakels. Edhe në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit ka raste kur emra të njëjta shfaqen në dy forma të ndryshme, me dallim të vogla gjuhësore, por të patolerueshme në një dokument zyrtar.



## MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike ([www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi.

ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në analiza profesionale mbi problematika specifike politike me progresin dhe zhvillimet politike në Shqipëri. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike, të drejtësisë dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese dhe analiza politike mbi zhvillimet kryesore në vend.

### DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TË REALIZUARA & NË PROCES NGA ISP

- Database [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al) mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-2020)
  - Database dhe monitorimin e ligjit të dekriminalizimit (2016-2021)
  - Monitorim e institucioneve të sistemit të drejtësisë (nga 2019 dhe në vijim)
  - Monitorimin e ligjërimit politik e publik mbi reformën në drejtësi (2018 dhe në vijim)
  - Monitorimin e konfliktit të interesit në aktivitetin parlamentar (2019 -2020)
  - Monitorimin e progresit të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian (2017 dhe në vijim)
  - Monitorimi i qeverisje vendore, bashkitë e qarkut Tiranë (2018-2019)
  - Database online [www.muzeumemories.info](http://www.muzeumemories.info) Shqipëria në periudhën komuniste
  - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (nga 2015).
  - Monitorimin e reformës zgjedhore dhe komentat (broshurë) mbi ligjin “Mbi partitë politike”
  - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2017) dhe në zgjedhjet lokale 2015
  - Monitorim të Kuvendeve Kombëtare të partive kryesore. Anketime dhe raporte mbi gjetjet
  - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (nga 2014 dhe në vijim)
- ❖ Raporti do t’u shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
  - ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur)
  - ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, emailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

### CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Krasniqi, Afrim

Reforma në drejtësi: nga vetingu tek jetësimi i institucioneve të reja : bilanci i reformës 2018-2019: monitorim dhe problematika / drejt. Afrim Krasniqi. - Tiranë : Instituti i Studimeve Politike, 2019

ISBN 978-9928-4418-9-8

1.Drejtësia 2.Reforma 3.Monitorime 4.Shqipëri  
34.04(496.5) “2018/2019”



